



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 E 31 MARS DHE 11 PRILL 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. I 31. MARTA I 11. APRILA 2017. GODINE**

**MARS/PRILL - MART/APRIL
2017**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST sh. a. dhe operatorit të sistemit, të transmissionit dhe tregut-KOSTT sh. a.,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-157 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit të Projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L- 074 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-138 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-142 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore,
9. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
14. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
15. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
16. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Dnevni red

1. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-137 o ratifikaciji Sporazuma u vezi osnivanja Fonda Zapadnog Balkana,
2. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-149 o ratifikaciji Sporazuma za osnivanje Regionalne kancelarije za omladinsku saradnju između Kosova, Albanije, Bosne i Hercegovine, Crne Gore, Makedonije i Srbije,
3. Razmatranje N/zakona br. 05/L-151 o ratifikaciji Sporazuma o saradnji Kosovo-Albanija, za razmenu i/ili podelu regulatorne rezerve između Regulatora Prenosnog Sistema OPS D.D. i Operatora sistema prenosa i tržišta - KOSTT d.d.,
4. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-157 o ratifikaciju Sporazuma finansiranja Projekta o sigurnosti vode i zaštita kanala, potpisan između Vlade Republike Kosova i Međunarodne asocijacija za razvoj,
5. Prvo razmatranje N/zakona o socijalnim preduzećima,
6. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-074 o visokom obrazovanju u Republici Kosova,
7. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-138 o Memorijalnom kompleksu “Adem Jashari” u Prekazu,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-142 o zaštiti od zračenja i nuklearne sigurnosti,
9. Glasanje o N/zakona br. 05/L-128 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-163 o rudnicima i mineralima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L158,
10. Drugo razmatranje N/zakona br.05/L-129 o izmenama i dopunama Zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-134 o legalizaciji i predaju kratkog i lakog oružja, municije i eksplozivnih sredstava,
12. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-091 o zaštiti od buke,
13. Drugo razmatranje N/zakona br.05/L-127 o dopuni Zakona br. 04/L-033 o Specijalizovanoj komori Vrhovnog suda Kosova u vezi pitanja Kosovske agencije za Privatizaciju,
14. Glasanje Predloga- rezolucije, u vezi hapšenja aktivista Pokreta “Vetëvendosje”,
15. Formiranje Ad -hoc komisije za izbor jednog (1) člana Borda RTK-a,
- 16 Izbor jednog (1) člana Sudskog saveta Kosova iz redova Srpske zajednice.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2017.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, i kemi dy propozime. Nait Hasani ka kërkuar fjalën dhe profesori Muhamet Mustafa e ka një propozim, po ashtu.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Unë kërkoj që nga rendi i ditës pika që është Projektligji për arsimin e lartë të hiqet ose të shtyhet, për shkak se ky projektligj ka ardhur në komisionin tonë më 24. 11. 2015, ku gati veç një vit e gjysmë po shkojnë dhe kanë ndryshuar rrjedhat, ngjarjet. Prandaj, po kërkoj që të na jepet mundësia edhe një herë ta rikthejmë në komision, ta shqyrtojmë dhe ta plotësojmë dhe të dalim tani me një qëndrim më të mirë.

Prandaj, po kërkoj që edhe ministria të pajtohet ta heqim nga rendi i ditës nga seanca e sotshme.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

62 deputetë jemi në sallë, atëherë në qoftë se dëshironi ta largoni nga rendi i ditës duhet shumicë e thjeshtë.

Urdhëro, zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Kryetar, ka kohë që ne e kemi kërkuar Ligjin e arsimit të lartë, ka kohë që ligji ka qëndruar, në fakt, është tërhequr në mënyrën më jo të rregullt një periudhë të gjatë kohore, edhe tani ligji ka ardhur dhe unë jam kundër që ligji të tërhiqet, por të kthehemi të punojmë, sepse është shumë e nevojshme që të plotësohet, të ndryshohet Ligji i arsimit të lartë.

Unë nuk e di arsien pse të kërkohet përderisa Qeveria ka më shumë se një vit e gjysmë që e ka tërhequr në seancë për disa konsultime, e në fakt sot ka ardhur, ne si anëtarë duhet të kthehemi të punojmë në ligj, të punojmë edhe me ekspertë dhe të punojmë në interes të arsimit të lartë. Pse thjesht të tërhiqet sot ligji, unë nuk e kuptoj, nuk jam për ta tërhequr, jam për t'u kthye për të punuar. Nëse Qeveria, ministria ka bërë thjesht gabime, normal se ne i kemi arsyet e tona, ne si anëtarë të komisionit duhet të punojmë bashkë me ekspertët dhe ta bëjmë një ligj të arsimit të lartë në interes të arsimit të lartë, jo në interes as të individëve, as të partive politike.

KRYETARI: A të shkojmë në votim të thjeshtë, zoti Morina, fjala për ju, Enver Hoti, po, po kush dëshiron.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike pajtohet me propozimin e kryetarit të komisionit që ky projektligj të kthehet në komision për shkak të afateve, të cilat janë tejkaluar dhe mendoj që gjatë kësaj periudhe domethënë është edhe rezultati PISA dhe shumë çështje kanë ndryshuar në aspektin e arsimit. Mendoj që komisioni ka nevojë që në këtë ligj të fusë edhe amendamente të tjera dhe ta pasurojë këtë ligj me çështje më të mira për fushën e arsimit.

Prandaj, ne pajtohemi sikur parlamentarë që ky projektligj të kthehet në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Hoti, fjala për ju.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Me të vërtetë është e pakuptimtë kjo kërkesë nga kolegët deputetë, por megjithatë është propozim i tyre, ide e tyre, nuk do ta komentoja shumë, por nëse ministria dhe Qeveria ka ndonjë arsye për ta tërhequr këtë projektligj si sponsorizues, duhet të na e sqarojnë.

Përndryshe, sa i përket arsytimit të kolegëve deputetë mendoj që brenda dy leximeve deputetët mund ta japin kontributin e vet për ato çështje që i potencuan dhe mendoj se kemi kohë të mjaftueshme që të gjithë deputetët ta luajmë rolin pozitiv, ta japim më të mirën, por le ta bëjë Qeveria këtë punë, mendoj, ose deputetët kanë marrë rolin e zotit Bajrami. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kurteshi e ka fjalën në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Është e vërtetë që ky ligj ka nevojë për korrigjime dhe përmirësime jashtëzakonisht të mëdha, por duke pasur përvojën e keqe të tërheqjes së ligjeve, të cilat tërhiqen për 10 e 15 ditë, e vonohen dy vjet, mendoj që ligji duhet të shqyrtohet sot në leximin e parë dhe pastaj komisioni ka mundësi t'i bëjë ndryshimet e duhura që janë të shumta. Pra është e mundur të bëhen këto korrigjime dhe në leximin e dytë ligji të vijë ashtu siç do të duhej të vinte para deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Simiq e ka kërkuar fjalën, edhe “6+”, pastaj shkojmë në votim.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani poslanici,

Poštovani Vladin kabinetu,

Poslanička grupa Srpske Liste podržava predlog poslanika Naita Hasanija da se ovaj Nacrt zakona povuče sa dnevnog reda, i mi podržavamo taj predlog. Hvala!

KRYETARI: Grupi "6+", zonja Myfera Serbica Shinik e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: "6+" Parlamenter Gurubu da ayni şekilde Nait Hasani'nin önerisini desteklemektedir.

KRYETARI: A dëshirojnë deputetët të shprehin qëndrim se kanë kërkuar fjalën për këtë çështje. A po shkojmë në votim për këtë çështje. Ministri gjithsesi, por mendova deputetët. Ministri i Arsimit rreth Ligjit për arsimin e lartë.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Unë sot jam përgatitur për ta bërë ekspozenë në leximin e parë të ligjit. Është e vërtetë që ky ligj ka më shumë se një vit që është shtyrë një kohë të gjatë për shkak të mungesës së opozitës, pastaj edhe për shkak të bojkotit të Listës Serbe.

Nëse Komisioni për Arsim vlerëson se ka nevojë për konsulta shtesë, atëherë ne nuk kemi telashe, në qoftë se donë ta azhurnojnë mendimin e vet, të cilin e kanë dhënë pozitiv para një kohe, nuk kemi telashe, por ligji nuk tërhiqet, është në seancë për të vendosur për trajtimin e tij të mëtejshëm.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Ju lutem, kolegë deputetë, me votim formal me ngritje dore, janë 74 deputetë në sallë. Zoti Kurteshi ka nevojë për replikë.

ISMAJL KURTESHI: Vetëm desha ta përkujtoj ministrin që opozita është kthyer në Kuvend që një vit, kështu që nuk qëndron fakti që për shkak të mungesës së opozitës ky ligj nuk ka qenë. Bile edhe kur ka munguar opozita 90 deputetë kanë qenë brenda, kështu që mospunën tuaj mos u mundoni ta arsyetoni me mungesë të opozitës në Kuvend, sepse po të mos ishte pozita e aftë t'i kryejë punët edhe pa opozitën, duhet shkuar në fushatë siç po shkoni ju dhe sa më shpejt të shkohet në zgjedhje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë përgatitemi për votim, me votim formal. Në qoftë se shumica janë për, unë i pyes vetëm kush është kundër. Veç kush është kundër, me elektronikë.

Atëherë lus kolegët deputetë, edhe regjinë, të bëhen gati për votim.

Pika e gjashtë e rendit të ditës është propozim i kryetarit të komisionit, zotit Nait Hasani, të tërhiqet nga leximi i parë. Përgatitemi për votim, votojmë tash, edhe t'i kthehet komisionit.

Pika e gjashtë, Ligji për arsimin e lartë, kërkohet nga kryetari i Komisionit për Arsim, zoti Nait Hasani që të tërhiqet nga pika e rendit të ditës, përkatësisht t'i kthehet komisionit përkatës.

Votojmë tash për këtë, kush është për, kundër, pro.

66 deputetë në mënyrë elektronike kanë votuar, 42 janë për ta larguar nga rendi i ditës, 22 kundër dhe 2 janë abstenime. Kështu që largohet nga pika e rendit të ditës pika gjashtë, Projektligji për arsimin e lartë.

Kemi një propozim tjetër, po ashtu për rend të ditës.

Zoti Muhamet Mustafa ka një propozim që të futet pikë e rendit të ditës në seancën plenare të sotshme Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 05/L-158 për shoqëritë tregtare.

Urdhëroni, zoti Mustafa, arsyetimin!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Ne kemi marrë nga Qeveria, përkatësisht Ministria për Tregti dhe Industri Projektligjin numër 05/L-158 për shoqëritë tregtare, i cili bën një avancim në mjedisin biznesor dhe mjedisin investues dhe ka një rëndësi më të madhe që Kosova të bëjë edhe disa përmirësime, të cilat janë të rëndësishme për klimën e biznesit.

Ne e kemi trajtuar këtë projektligj të martën në komision, e kemi përkrahur në parim dhe kemi propozuar që Kuvendi ta shqyrtojë në parim këtë projektligj në mbledhjen e sotme, e nëse e konsiderojmë që është sot e ngarkuar, eventualisht në mbledhjen e nesërme. Domethënë për komisionin është, ne kemi propozuar konkretisht për mbledhjen e sotme, por mundet edhe në mbledhjen e nesërme, nuk bëhet vonë. Javën tjetër do të ishte vonë, për arsye se sugjerimi i Komisionit është që ky ligj t'i kryejë procedurat në mënyrë pak më të përshpejtuar dhe të aprovohet diku deri më 10 maj, në mënyrë që të kemi mjaft kohë edhe për diskutim rreth ligjit, por gjithashtu ta aprovojmë deri në një datë kur është e rëndësishme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, profesor i nderuar!

Po Naim Frashëri na ka mësuar që “punën e sotme të mos e lëmë për nesër”, edhe Salihu ma konfirmoi, po e vendosim sot, në qoftë se e vendosim, ose hiq.

Urdhëro, zonja deputete, a e dëshiron fjalën? Më fal, bëre me dorë, thashë mos po e do fjalën.

Shkojmë në votim, duhen 2/3 e të pranishmëve për t'u futur pikë e re e rendit të ditës, askush s'ka kërkuar fjalën.

79 deputetë janë në sallë, shkojmë me votim elektronik. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Kemi një propozim për plotësimin e rendit të ditës në seancën plenare të sotshme: Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 05/L-158 për shoqëritë tregtare, votojmë tash:

Atëherë ka kaluar, futet pikë e rendit të ditës.

Më lejoni të konstatoj votimin: 68 deputetë kanë votuar, 50 për, 9 kundër dhe 9 abstenime, do të thotë është pikë e veçantë e rendit të ditës në seancën e sotme plenare: *Shqyrtimi i parë i Projektligjit Nr. 05/ L- 158 për shoqëritë tregtare.*

Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, tash futemi në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

Komisioni Funkcional për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Kuvendit i ka rekomanduar për votim. E kisha lutur regjinë t'i thërrasë kolegët deputetë për arsye se duhen mbi 80 vota. Do të thotë, për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Punëve të Jashtme, po e shoh se nuk është. Kryetari i komisionit, zoti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: I nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Jashtme, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2017, e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, nr. 05/L-137.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit komisioni ka konstatuar se ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet të cilit promovohet zhvillimi i bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet palëve kontraktuese,

forcimi i lidhjeve ndërmjet palëve kontraktuese, integrimi i palëve kontraktuese në Bashkimin Evropian dhe prezantimi i përbashkët i palëve kontraktuese në vendet e treta.

Komisioni duke vlerësuar se me këtë projektligj Republika e Kosovës merr pjesë aktive në promovimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit kulturor, shkëmbimet shkencore, hulumtimeve dhe bashkëpunimeve në fushën e arsimit ndërmjet palëve kontraktuese dhe se e avancoon statusin e saj në arenën ndërkombëtare duke qenë e pranishme në forumet ndërkombëtare shumëpalëshe, ka rekomanduar miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkritazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Dua të theksoj këtu që ky votim ka qenë me shumicë votash dhe ne si komision e kemi mbështetur si tërësi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të votojmë, a i kemi 80 deputetë brenda? Po, kemi kuorum! Atëherë, fjalën e ka kërkuar deputetja Puhie Demaku.

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Deputetë dhe deputete të nderuara,

Më 24 shkurt 2012, në Bruksel është nënshkruar marrëveshja për përfaqësimin e përbashkët rajonal, e njohur më vonë si Marrëveshja për fusnotën. Ministrja Tahiri asokohe e quajti fusnotën “fluskë dëbore që do të shkrihej me kohë”.

Në ndërkohë kanë kaluar hiç më pak se pesë pranvera dhe pesë vera, e kjo fusnotë jo që nuk është shkrire, por është ngurtësuar si kurrë më parë. Fusnota e famshme që në vitin 2012 u trumbetua si sukses për Kosovën dhe e gjeti mbështetjen e shumë deputetëve, si të pozitës, ashtu edhe të opozitës të asaj kohe, që tash që janë në Qeveri, shumë shpejt u dëshmuua që të ketë qenë një marrëveshje e pamenduar mirë, një koncesion me pasoja të rënda për subjektivitetin e shtetit, e cila nuk prodhoi asnjë rezultat pozitiv për Kosovën. Si e tillë filloi të kundërshtohet më pas edhe nga vetë deputetët e partive në pushtet që dikur e kishin mbështetur. Pas kësaj marrëveshjeje, Serbia, jo që nuk ndryshoi qasje ndaj Kosovës, ajo u bë madje edhe më agresive në përpjekje të saj për t’ia pamundësuar Kosovës përfaqësimin në mekanizma multilateral.

Dhe, përkundër tërë kësaj përvoje të hidhur dhe dëshmime të njëpasnjëshme se fusnota nuk prodhon asnjë rezultat frytdhënës, presidenti i gazit në kohën kur qe ministër i Jashtëm e vuri firmën e tij me një marrëveshje ku ai në emër të të gjithë qytetarëve të Kosovës e pranon që Kosova me fusnotë, pra me subjektivitet të cunuar, të bëhet bashkëthemeluese e një nisme rajonale. Kjo marrëveshje sot është sjellë në Kuvend për t’iu nënshtruar votimit.

Pra, po flasim për një nismë të re, jo organizatë ekzistuese. Në mekanizmat ekzistues ka rregulla ekzistuese dhe anëtarët duhet t'u përshtaten atyre rregullave. Fondi për Ballkanin Perëndimor është mekanizëm i ri, në të cilën jemi anëtar themelues dhe qysh në start ne po ia caktojmë vetes dhe rregull vetvetes do të thotë që të mos përfaqësohemi si shtet, por si Kosovë me fusnotë.

Kuvendi i Kosovës sot është para një sfide të rëndësishme. Nuk mund ta quani veten edhe deputetë të Republikës, edhe deputetë të fusnotës. Pra duhet të zgjidhni, o jeni të Republikës, o jeni të fusnotës. Është thënë se nuk duam ta përjashtojmë Kosovën nga një fond i rëndësishëm si ky, e kush po thotë që duhet ta përjashtojmë Kosovën? Pse të mos përjashtohet Serbia nëse nuk pajtohet që ne të jemi republikë? Pse duhet ne të heqim dorë nga subjektiviteti ynë dhe cili është çmimi, për të cilën qenkeni në gjendje ta shitni republikën në fakt, sepse për një shtet si Kosova me të kaluarën e saj nuk ka çmim që e paguan atë që tashmë është paguar me jetë njerëzish.

Unë po ju tregoj tashmë që zëvendëskryetarja e këtij Kuvendi nga radhët e “Vetëvendosjes”, Aida Dërguti, në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit ka propozuar që nëse ky Kuvend është i gatshëm që bashkërisht të nxjerrë një deklaratë ku themi që ne si Kuvend, si shpallës të Republikës së Kosovës dhe pavarësisë së saj nuk kemi kurrfarë ambiguiteti mbi statusin e republikës sonë dhe subjektivitetin tonë ndërkombëtar, atëherë kjo do t'i hapte rrugët që edhe ne ta mbështetim si opozitë këtë marrëveshje. Mirëpo, përderisa ajo është me fusnotë dhe nuk kemi një deklaratë të tillë, ku ne distancohemi nga fusnota si institucion, ky do të përbente një precedent tepër të rrezikshëm për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe madje do të ishte diçka që ne kundërshtojmë vetë shpalljen e Republikës së Kosovës.

Unë ju ftoj prapë që nëse nuk e kemi deklaratën të mos e votoni, sepse marrëveshja në original është me fusnotë dhe ne si Kuvend nuk guxojmë ta bëjmë një gabim të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash u paraqitën edhe tre. Unë do t'ua jap fjalën normalisht. Zafir Berisha e ka kërkuar fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Arsye u bë kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme që unë ta marr fjalën, meqë në fund tha që “si komision jemi pajtuar në tërësi”, në fakt nuk qëndron kjo. Ne bashkë edhe me “Vetëvendosjen”, edhe me Aleancën e kemi kundërshtuar këtë marrëveshje, jo pse ne nuk jemi që Kosova të jetë pjesë e marrëveshjeve të ndryshme, edhe rajonale, edhe më gjerë, mirëpo si Kuvend mendojmë se në rast se e votojmë një marrëveshje me fusnotë, ne në fakt jemi në shpërputhje me përcaktimin tonë kushtetues dhe me Deklaratën e Pavarësisë.

Vazhdimisht i kemi kundërshtuar marrëveshjet e dëmshme për Kosovën, edhe marrëveshja që Kosova të prezantohet me fusnotë është e papranueshme, prandaj unë kisha kërkuar edhe nga kolegët tjerë deputetë që me dorën e tyre të mos e votojnë një marrëveshje, e cila e vë Kosovën

në pikëpyetje në raport me shtetet tjera pjesë të kësaj marrëveshjeje. Prandaj, duke e parë këtë gjendje në të cilën e ka futur kjo Qeveri e papërgjegjshme vendin, ne si “Nisëm” nuk do të marrim pjesë në votim, ose do të abstenojmë.

KRYESUESI: Reçica, çfarë do ti? Replikë? Urdhëro, replikë!

ELMI REÇICA: Një sqarim shumë shkurtër!

Unë e thashë në fund të fjalës sime që kjo marrëveshje është votuar me shumicë votash, do të thotë nuk thashë që kemi qenë unikë. Kështu që për zotin Berisha e kam fjalën, vetëm këtë të sqaroj.

KRYESUESI: Ministër, e do fjalën?

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti nënkryetar Hamiti!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Mendoj që këtë projekt-marrëveshje e kemi pasur disa herë në Kuvend të Kosovës, teksti i saj, përmbajtja e saj është e njohur për të gjithë. Unë mund ta prezantoj në vija të shkurta dhe shumë të përgjithshme edhe njëherë për qëllim të informimit më të plotë në raport me ju, por edhe me qytetarët e Kosovës.

Në nëntor të vitit 2015, në Pragë, është nënshkruar Marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, i cili fond do të duhej t'i përfshijë gjashtë vendet e mbetura të rajonit jashtë Bashkimit Evropian, një pjesë e tyre janë edhe jashtë NATO-s dhe marrëveshja nuk është asgjë tjetër, veçse një hulumtim i një fondi të njëjtë, i cili ekziston në vendet e Evropës Qendrore, në shtetet e Grupit të Vishegradit, që përfshin: Poloninë, Hungarinë, Çekinë, Sllovakinë dhe këto vendet e Evropës Qendrore.

Do të thotë, sipas modelit të vendeve të Vishegradit do të duhej një fond i tillë tash i stacionuar në Tiranë, i vendosur me seli në Tiranë, mbështet projekte që kanë të bëjnë me integrimin e Bashkimit Evropian dhe Agjenda e Integritimit Evropian për ne është prioritet. Anëtarësimi ynë në BE është i natyrës strategjike, ka të bëjë me ekzistencën tonë. Do të duhej të mbështeste bashkëpunimin ndërmjet palëve në shkëmbime akademike, në hulumtime shkencore, në kërkim shkencor, në fushën e arsimit. Do të duhej t'i mbështesë të rinjtë e vendeve të Ballkanit Perëndimor që ta kenë bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe këto janë përafërsisht ato fushat të cilat i mbulojnë.

Unë e di që deputetët, edhe të koalicionit qeverisës, edhe të opozitës i kanë pasur dy shqetësime kryesore dhe dua të jem shumë i sqarues në raport me këto dy shqetësime kryesore. Së pari, ka

pasur një shqetësim që mos selia e një fondi të tillë do të ishte krijimi i njëfarë hapësire neojugosllave, njëfarë sferë neojugosllave. Unë dua të ju them që kjo nuk është e vërtetë. Ne si Qeveri e Kosovës e kundërshtojmë çdo tendencë të Serbisë, qoftë për dominim diplomatik, qoftë për rritje të kapacitetit ushtarak të saj në rajon, qoftë edhe për t'i përdorur organizatat e ndryshme rajonale si platforma për dominim, por nuk ka të bëjë me këtë. Nëse do të ishte fjala për diçka të tillë, po ju them me sinqeritetin më të madh, edhe unë ju kisha thënë mos e votoni dhe nisma të tilla në të kaluarën i kemi kundërshtuar edhe para 3, 4, 5 vjetëve, por ky është një fondacion i cili mbështet projekte në arsim të lartë, në kërkim shkencor, në kulturë, ndërmjet të rinjve dhe nuk është ndonjë organizatë ndërqeveritare, e cila do të duhej ta fomërsonte të ardhmen e Ballkanit Perëndimor.

Shtetet kombe do të mbeten ato që janë, shtetet të cilat janë në rajon do të mbeten ato që janë, kjo është vetëm një organizatë, një fondacion i cili do të duhej të ketë fusha konkrete të bashkëpunimit. Kështu që i kisha lutur të gjithë deputetët, edhe të koalicionit qeverisës, edhe të tjerët, meqë ma merr mendja që politika e jashtme është një fushë e cila duhet të na bashkojë. Unë e di që ka shqetësime prej opozitës për temat e dialogut dhe për fushat e tjera, por ma merr mendja që ky nuk është ndonjë shqetësim dhe shqetësimi i dytë është te përdorimi i asteriksit dhe i fusnotës. Ne një marrëveshje të tillë e kemi pranuar para disa vitesh, e di që ka qenë kompromis i dhimbshëm, e kam thënë në atë kohë, po e them edhe sot në këtë Kuvend, ka qenë mënyra e vetme se si ne të anëtarësohemi në 40 organizata rajonale në të cilat është Kosova dhe natyrisht që kjo marrëveshje është e përkohshme dhe natyrisht që kjo marrëveshje nuk e shkel as sovranitetin e jashtëm të Kosovës, as subjektivitetin e saj ndërkombëtar dhe si e tillë do të vlejë për një kohë.

Por, apeli im është i kësaj natyre dhe do të dua të ju them shumë qartë, është i vetmi vend në rajon, i cili deri më tash nuk e ka ratifikuar një marrëveshje të tillë, dhe ne jemi duke dalë si Kosovë në raport me rajone joserioz, meqë ky Kuvend nuk ka kapacitet të votojë herë pas here marrëveshje, të cilat janë të natyrës ndërkombëtare dhe, së dyti, shteti shqiptar ekziston plot 100 vjet, është organizata e parë, e para dhe e vetme që do ta ketë selinë në Tiranë. Kurrë organizatë rajonale ndërkombëtare deri më tash në gjeografinë e shtetit shqiptar nuk ka pasur, kështu që ju kisha lutur të gjithë juve që ta votoni. Dua të ju heq çdo hezitim që keni sa i takon Ballkanit Perëndimor, por ju kisha lutur të gjithë juve që ta votoni këtë marrëveshje, është në interes të shtetit të Kosovës, është në interes të partneritetit strategjik që e kemi me Shqipërinë dhe po të ishte diçka tjetër edhe unë s'kisha pasur interes. Cili është interesi ynë i Kosovës, me çdo kusht ju lus unë që ta votoni këtë marrëveshje. Interesi ynë është i kësaj natyre, që duhet të jemi kredibil në raport me vendet e rajonit dhe me Bashkimin Evropian dhe që duhet të jemi shumë kredibil në raport me Shqipërinë. Selia vendoset në Tiranë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vjosa Osmani e ka kërkuar fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju lutem për pak vëmendje, se nuk a kam ndërmend të ngre zërin.

E mora fjalën për t'i dhënë disa sqarime.

E para, që në kohën kur LDK-ja ka qenë në opozitë nuk ka qenë pro marrëveshjes për fusnotë, në fakt janë dhënë deklarata, edhe gojore, edhe me shkrim, në atë kohë që kanë kundërshtuar marrëveshjen për fusnotë për arsye të shumta dhe nuk është e vërtetë, pra që e ka përkrahur.

E dyta, nuk është hera e parë që një marrëveshje ndërkombëtare me fusnotë po votohet në këtë Kuvend, Marrëveshja për Stabilizim-Asociim që është votuar edhe nga disa parti opozitare, po ashtu ka pasur fusnotë. Dhe edhe disa marrëveshje të tjera ndërkombëtare, nga të cilat Kosova ka përfitur fonde të ndryshme, në fusha të ndryshme, kanë pasur fusnotë.

Unë e di që një parti opozitare ato i ka kundërshtuar vazhdimisht, por jo të gjitha. Ne sot duhet ta kuptojmë se cila është alternativa tjetër, në qoftë se votohet kundër kësaj marrëveshjeje. Alternativa do të jetë izolimi i Kosovës nga të gjitha këto nisma rajonale, pra Kosova nuk do të ketë zë. Nuk është njëjtë sikur Kosova të flasë për veten, sikur Shqipëria të flasë për Kosovën. Kosova nuk do të mund të paraqesë projekte të rëndësishme, qoftë ato që prekin rininë, qoftë ato që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, që kanë të bëjnë, për shembull me hekurudha, me autobusë për disa komuna të tjera, e shumë e shumë projekte të tjera, që e prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve, për shkak të një gabimi të Qeverisë së kaluar, e cila na ka vendosur neve para aktit të kryer.

Pra, ne ose duhet të marrim pjesë në këto nisma dhe të përfitojnë qytetarët e saj deri në momentin kur kjo Qeveri ose një qeveri e ardhshme rinegocion pozicionin e saj me Bashkimin Evropian dhe e largon këtë fusnotë, ose duhet tërësisht të izolohehi duke e pritur atë moment.

Unë mendoj, se meqenëse jemi para një akti të kryer dhe, meqenëse tashmë edhe Marrëveshja për Stabilizim-Asociim dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare janë ratifikuar në këtë Kuvend me qëllim të përfitimit të qytetarëve të Kosovës, që të mos bëjmë hapa prapa duke izoluar Kosovën tërësisht.

Pra, nuk është situata kush e pranon Republikën e kush s'e pranon Republikën, sepse unë mendoj se për qytetarët e Kosovës është tërësisht e qartë se kush në këtë Kuvend nuk e pranon Republikën e Kosovës, as nuk ka nevojë të jepen argumente për një gjë që është e pastër si loti.

Kështu që, para një situatë të tillë, kur nuk bëhet zgjedhja në mes "Republikës së fusnotës", por zgjedhja bëhet ndërmjet një marrëveshjeje e cila të jep mundësi që të përfitosh diçka për qytetarët e Kosovës dhe largimi nga kjo marrëveshje, pra që të izoloni tërësisht nga projektet rajonale. Pas kësaj ne do të votojmë për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor për Zyrën

rajonale për bashkëpunim rinor, që e përfshinë edhe Kosovën dhe shtetet tjera të rajonit. Edhe aty, sa e kuptoj, selia do të jetë në Tiranë.

Kërkesa ime tani, është që Qeveria e Kosovës të insistojë më shumë që të ketë, qoftë selinë, qoftë udhëheqjen e këtyre nismave rajonale dhe jo gjithnjë të pranojë, që qoftë Serbia, qoftë Tirana, ta përjashtojnë komplet Kosovën nga një rol aq i rëndësishëm në këto nisma. Procesi i Berlinit s' duhet ta ketë për qëllim që Kosovën mos ta trajtojë si shtet të barabartë me të tjerët.

Pra, në qoftë se fusnota tashmë po na vendos në një nivel jo të barabartë, atëherë mos të pranojmë që edhe në fusha të tjera, pra qoftë udhëheqja e këtyre zyrave, qoftë selia e këtyre zyrave, tërësisht ta përjashtojë Kosovën si një shtet i rëndësishëm që kontribuon, qoftë me ide, qoftë me projekte në nisma të tilla dhe është shteti më i rëndësishëm në rajon, sa i përket sigurisë dhe stabilitetit.

Kështu që, unë shpresoj që Qeveria ta ketë këtë parasysh dhe mos të dorëzohet përballë asnjë shteti të rajonit dhe jo vetëm përballë Serbisë, këtu po e potencoj, asnjë shtet të rajonit, dhe të kërkojë me ngulm që të ketë rol më të rëndësishëm në këto nisma dhe, jo sikur në këto të dyja të cilat tani po i votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Po dua t'i referohem ministrit. Kurrkush nuk është kundër nismave rajonale, aq më tepër kur këtyre nismave, për shembull, u prinë Tirana zyrtare, por asnjë fije nacionalizmi nuk shoh të fshihet pas kësaj, e para.

E dyta, ne i kemi tri raste, kur pikërisht pse është në Tiranë ju e pranoni fusnotën mbi Pavarësinë e Kosovës, Republikën e Kosovës. Mendoj se, kjo është një gabim dhe është një papërgjegjësi totale. Hajde, nuk paskemi çfarë t'i bëjmë Serbisë edhe në pjesë tjera ku nuk është njohur Republika e Kosovës, por në një marrëveshje me Shqipërinë të qitet fusnota, është krejtësisht e papërgjegjshme.

Edhe... e dëgjova kolegen më herët, tha: "i kanë dhënë votën pro MSA-së..." Sa për kujtesë, ne kemi abstenuar, nuk e kemi dhënë votën për, por prej ditës që është shpallur Pavarësia e Kosovës e deri më sot nëpërmes dialogut, qoftë teknik apo politik, si të doni quajeni, kemi pasur një rënie të lehtë, ose heqje dorë prej Pavarësisë së Kosovës.

Ajo "fluska" e Edita Tahirit tash nuk po duket se po mbetet bash fluskë. Kështu që ta kuptojmë drejtë, nuk jemi kundër, por jemi kundër fusnotës, jo kundër marrëveshjeve. Nuk e ka as opozita, e besoj që asnjë prej nesh këtu, qëllim për ta izoluar Kosovën, përkundrazi ato marrëveshje, që

thatë ju parëz se po tregohemi joseriozë ministër, kur nuk po ratifikojmë marrëveshjet ndërkombëtare. Joseriozë janë ata që i krijojnë këto marrëveshje. Se pasi që po i krijojnë këto marrëveshje po vijnë në Kuvend e pastaj kur po diskutohet po shihet se ato marrëveshje nuk kanë qenë të qëlluara.

Për të gjitha marrëveshjet që janë kontestuar dhe s'keni mundur t'i kaloni, pikërisht ekzekutivi e ka fajin, që i ka arritur këto marrëveshje e nuk e ka besimin e deputetëve.

Kështu që, mos e "gjuani topin" kah deputetët, por mbani përgjegjësitë vet. Para se t'i nënshkruani ato marrëveshje konsultohuni pak, diskutoni pak dhe ejani në një përfundim, në mënyrë që edhe ne t'ua japim votën për, përndryshe, përderisa ju bëni marrëveshje të papërgjegjshme, natyrisht se e keni votën kundër.

KRYESUESI: Faleminderit! Qerim Bajrami e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Kao član Komisije za vanjske poslove i drugi potpredsednik, koji je učestvovao u svemu ovome, želim da kažem nekoliko riječi.

Počeu od toga da prije otprilike dva mjeseca, kad smo bili u posjeti Tirani, dakle Republici Albaniji, u Skupštini Republike Albanije nam je rećeno direktno od predsednice Komisije za vanjske poslove uvažene profesorice Arte Dada, ne bi trebalo da ne glasate ovaj sporazum jer je po prvi put Tirana je centar na Balkanu.

Dakle, znamo na žalost da imamo tu fusnotu famoznu, međutim također podržavam dosadašnje diskusije, koje kažu da Kosovo kao država treba da ide naprijed. Mi od ovog sporazuma i od tog sjedišta u Tirani i od tog fonda ćemo imati samo koristi, ne možemo imati štetu. Na žalost, fusnota kao što sam rekao postoji, ali sve druge note, odnosno svi drugi kontributi Kosova u tom sporazumu i u tom fondu su državne. Dakle, Kosovo nema nikakve iznimke u odnosu na ostalih pet država koje su članice tog fonda.

Također, je jako važno da u ovom fondu će biti i Bosna i Hercegovina, što je za nas Bošnjake zasebno važno s obzirom da na žalost nemamo dobru saradnju sa tom državom, znamo zašto, i samim tim će preko ove regionalne saradnje biti uspostavljena i neka saradnja i neki kontakti i sa Bosnom i Hercegovinom.

Ja pozivam sve poslanike da izglasamo ovaj sporazum, jer je on u interesu svih građana Kosova i naše države. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PARAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Nuk është mirë që këto pika ka kohë që shtyhen dhe nuk janë votuar në Parlament, për më tepër nuk është mirë që këto marrëveshje deri më tash nuk janë ratifikuar. Nuk e di ku do të na çojë, në hapje ose rihapje të një debati për fusnotën pas shumë vitesh, në kohën kur ne duhet të bëhemi sa më shpejt pjesë e të gjitha nismave rajonale.

Unë jam plotësisht dakord për të biseduar dhe për të trajtuar, se përse kaq vonë, ose përse është shty, pse kjo “flluska” mbeti kaq gjatë, e tjerë, e tjerë..., dhe është mirë që një debat i tillë të ndodhë së shpejti edhe me ministrin, me Qeverinë e në mes nesh dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë më shpejt.

Nuk e di se ku na çon edhe ai krahasimi, se kush ka qenë për e kush ka qenë kundër. Të ju them, se në Partinë Demokratike ndër debatet më të gjata në mandatin e kaluar dhe më shumë i diskutueshëm brenda nesh ka qenë pikërisht rreth kësaj çështjeje. Ne atëbotë kemi vendosur ta përkrahim pikërisht për shkak të çështjeve, që sot janë në temë.

Pra, pikërisht që vendit tonë, shtetit tonë, Republikës sonë, t’ia mundësojmë që të jetë pjesë e institucioneve ndërkombëtare, e nismave rajonale dhe të mos pengohet që të marrë pjesë dhe të zhvillohet në aspektin ndërkombëtar, të jetë pjesë e nismave dhe përfundimisht të jetë pjesë e institucioneve ndërkombëtare, normalisht e barabartë me shtetet dhe vendet tjera. Në këtë drejtim ne nuk duhet të hezitojmë.

Mendoj, se ministri duhet rishtazi të na tregojë se çfarë Kosova mund të humb nëse ne nuk i votojmë këto marrëveshje, që i kemi në dorën tonë sot. Për më tepër, mendoj se Kosova nuk do të ketë arsye pastaj edhe të jetë pjesë e nismave e takimeve të liderëve dhe të niveleve të larta, që janë mbajtur me ndërmjetësimin e vendeve të BE-së.

Dëshiroj të theksoj, po ashtu që Partia Demokratike e Kosovës dhe deputetët e saj sot janë për ta votuar këtë marrëveshje dhe i ftoj të gjithë deputetët, mendoj se duhet të jemi më të kujdesshëm kur të bëjmë krahasime të Republikës me fusnotën dhe nuk është aspak e moralshme, që ne të mos i njohim edhe simbolet e vendit tonë, kur është fjala në aktivitetet e brendshme dhe të ndryshme të vendit tonë e në anën tjetër, të kundërshtojmë edhe nisma të tilla, të cilat veçse avancojnë vendin tonë dhe na mundësojnë që në një periudhë tjetër, pse jo, të mos jemi vend i barabartë me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të BE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hoxhaj e ka kërkuar fjalën.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë desha vetëm të jap një sqarim të plotë në sugjerimet, dilemat, po edhe në propozimet që i patën deputetët.

Ne kemi një marrëveshje, e cila vërtet, kjo e asteriksit, ka qenë e vështirë, po e them për herë të dytë, por e cila në fund të fundit, na ka mundësuar që ne të anëtarësohemi në 40 organizata rajonale. Deri në atë kohë delegacionet e Kosovës, e dini ju deputetë, po e dinë prej atyre që merren me ambient, me miniera, me gjeologji, deri te ata që merren me aspekte të drejtësisë, që dilema në çdo takim e çdo konferencë ka qenë, se kush po hyn në sallë, kush po e lëshon tavolinën, a po e lëshon tavolinën Kosova, a po e lëshon tavolinën Serbia... Dhe, mua më është dashur, të paktën prej 2011-ës, vazhdimisht të thërras ndonjë përfaqësues të sekretarit të përgjithshëm në Kosovë, shefin e UNMIK-ut, e me i thënë, mos udhëto ti dhe mos e dërgo askënd të udhëtojë e të marrë pjesë në ndonjë konferencë.

Ne mund ta kemi edhe një debat për këtë temë dhe unë e pranoj, që denominimi i Kosovës, vendosja e asteriksit, ka qenë e vështirë, por e kemi pranuar. Dhe, apeloj për atë se pavarësisht kush është sot në Qeveri, kush do të jetë në të ardhmen, të ketë kontinuitet në politikë të jashtme, meqë shtetet serioze kanë kontinuitet.

Ka shumë vende që e kanë njohur Kosovën dhe më pas kanë pasur puç. Me ato vende ne i kemi vendosur marrëdhënie diplomatike me qeverinë e cila ka pasur puç. Se, shtetet serioze jashtë Evropës, jo vetëm në Evropë janë seriozë në sjellje ndërkombëtare, nuk sillen këtë javë në këtë formë e javën tjetër në formën tjetër.

E pranoj se ka qenë e dhembshme, por duhet ta kemi idenë e kontinuitetit dhe duhet ta dimë një përfitim, që ne e kemi marrë prej anëtarësimit të Kosovës në 40 organizata rajonale dhe dy qëllimet tona kryesore në raport me rajonin kanë qenë, se si të marrim njohje prej vendeve të Evropës Juglindore dhe se si të jemi pjesë e një bote multilaterale të organizatave ndërkombëtare në rajon. Unë pajtohem plotësisht çka tha zonja Osmani për punët e izolimit të Kosovës.

Nuk do të kemi fonde, jo vetëm prej kësaj organizate, por nuk do të ketë fonde edhe prej organizatave të tjera. Por, mua ma mori mendja se nuk duhet të dal këtu me ndonjë gjuhë të kërcënimit, sepse s'është as përshkrimi mi të flas në emër të BE-së e as e të tjerëve.

Unë po ju ftoj juve vetëm që ne të luajmë rolin tonë si shtet.

Së dyti. Ne sivjet, po them për herë të parë, do të aplikojmë në UNESCO.

Natyrisht se do të aplikojmë për në UNESCO, por s'jam prej atyre që nëpërmjet mediave 'online' cakton agjendën e politikës së jashtme.

Do të aplikojmë në Interpol. Do të aplikojmë në Këshillin e Evropës.

Po, a mendoni ju se dikush do të na e japë votën nëse ne si shtet, se në fund të fundit, jemi shtet, nëse ju e bllokoni një organizatë të tillë që të vendoset në Tiranë, e ju pritni që Tirana të llojë për ne, Mali i Zi të llojë për ne kur ka pasur presion më 2015 vetë kryeministri Gjokanoviç prej Vuçiqit dhe vetëm për punë të votës në UNESCO, kur kanë pasur presion maqedonasi që të dalin...

Pra, nëse ju dëshironi ta mbështetni integrimin e Kosovës në sistemin ndërkombëtar, harroni se mund të kemi vota ne në organizata të tjera të mëdha ndërkombëtare, ku thuhet Perëndimi me Rusinë për balancë të votave.

Prandaj, ju kisha lutur, dhe nuk po ju lus për të më dhënë votën mua për diçka të caktuar, sepse s'jam kandidat të bëhem Sekretar i Përgjithshëm i këtij Fondi në Tiranë, por ju kisha ftuar që të jemi kredibilë dhe seriozë e ta votojmë edhe këtë marrëveshje, edhe marrëveshjen që e ka ministri Shala.

Natyrisht se ne po luftojmë të marrim selitë e organizatave të tjera dhe njëra prej organizatave që ne po dëshirojmë të marrim selinë është një organizatë e madhe e transportit që duhet të vendoset në Kosovë.

Ne e kemi ndërtuar një autostradë e cila lidh Kosovën me Shqipërinë, ne po përfundojmë një projekt, i cili e lidh Kosovën me Maqedoninë, ne duam që brendi i Kosovës, imazhi i Kosovës të jetë një lloj habi-Kosova, na përcakton edhe gjeografia jonë në Ballkan dhe unë po ju them po ashtu, me kryeministrin Mustafa kemi biseduar disa herë me Komisararin Johanes Han dhe me zonjën Mogerini. Kjo seli, zoti Zharku e di, nuk është këtu... Pra, kjo seli, e cila do të vendoset në Kosovë, e kësaj organizate të transportit që është evropiane, pra nuk është e rajonit, po ashtu nuk do të ndodhë nëse ne e bllokojmë në pafundësi.

Është hera e tretë që kjo marrëveshje kthehet në këtë Kuvend.

Dhe, në fund, dua të ju them diçka që krejt e dini, por dua ta them si ministër i Jashtëm.

Në 99-tën e kemi pasur kontekstin ndërkombëtar më të favorshëm për Kosovën, edhe më 2008-ën, në shkurt kur e kemi shpallur pavarësinë, e kemi pasur kontekstin ndërkombëtar më të favorshëm, i cili po ndryshon çdo ditë.

Ne kemi marrë një vendim që me zor, gradualisht, me vullnet të pathyeshëm të integrojmë këtë shtet në sistemin ndërkombëtar me një rrugë shumë të veçantë, duke marrë njohje individuale, të cilat të tjerët s'kanë pasur nevojë t'i marrin, sepse janë anëtarësuar në OKB. Mali i Zi është pavarësuar më 2006, e ka mbajtur referendumin, ka hyrë në OKB, s'kanë vrapuar pas njohjeve ndërkombëtare.

Ne jemi detyruar që ta shtyjmë me zor, me vendosmëri dhe asnjëherë të mos dorëzohemi për anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme rajonale.

Ne kemi pranuar po ashtu, dhe këtë pa vullnetin tonë, një Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit po ashtu me asteriks, por pjesa më e bukur e MSA-së është titulli 2, i cili është dialogu politik dhe MSA-në e Kosovës e bën të njëjtë, të barabartë me të gjitha vendet e rajonit, dhe kemi negociuar 1 vit e gjysmë për këtë MSA.

Pastaj, ne kemi nisur një projekt bashkë në këtë vend, që gradualisht ta integrojmë këtë vend në sistemin ndërkombëtar, hap pas hapi.

Edhe vota për Fondin e Ballkanit Perëndimor është pjesë e një projekti. Unë nuk di a do të marrë edhe 10 vjet integrimi i Kosovës në sistemin ndërkombëtar a jo?

Por çdo hap që ne e marrim për çdo organizatë është i rëndësishëm.

Për këtë ju kisha ftuar... Për disa tema prej politikës së jashtme është mirë që kemi dallime sa i përket dialogut dhe dallimet që i kemi në Kuvend sa i përket dialogut ne na shërbejnë dhe i përdorim si gjëra pozitive, nuk i përdorim si gjëra negative. Pra, çdo gjë që ju e thoni në Kuvend, ne e përdorim në favor të forcimit të shtetësisë.

Pra, edhe një herë ju kisha ftuar. Nëse e doni lëvizjen e ngadalshme të Kosovës për t'u bërë pjesë, në daç të themi të sistemit ndërkombëtar, në daç të komunitetit ndërkombëtar, në daç të shoqërisë ndërkombëtare, dhe nëse keni pikëpamje, raporte të veçanta për Shqipërinë, është mirë t'ia kthejmë me të mirë Tiranës dhe është mirë të dalim kredibilë.

Unë për këtë temë më nuk flas në Kuvend. Ju vendosni. Është qëndrim dhe mendimi juaji dhe çfarëdo vote që ju e jepni do ta respektoj, por ishte obligim imi që t'i them disa fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Konsistenca në politikë është një vlerë shumë e çmueshme. Pa konsistencë, politika bëhet njëfarë fushe e paqëndrueshme e interesave, që vazhdimisht ndryshojnë prej konteksteve dhe shpeshherë përfundon edhe në oportunitizëm. Kështu që, në këtë kuptim dua të them se ne, nëse kemi thënë që është gabim fusnota një herë, nuk mendoj se tash duhet të pajtohemi me Qeverinë.

Unë mendoj se ne jemi deputetë të përgjegjshëm nëse synojmë t'i rregullojmë gabimet e Qeverisë. Jo që t'u shkojmë mbrapa dhe të bëhemi vagonë të kësaj lokomotive, e cila është në drejtim të gabueshëm, pa dyshim.

Pra, fusnota natyrisht se ishte një marrëveshje shumë e dëmshme, shumë e gabueshme e kësaj Qeverie, e cila natyrisht se është nënshkruar në mandatin e kaluar, në vitin 2012, por kjo ishte një zgjidhje të cilën vështirë se mund ta ndryshojmë për shkak se tash ndryshimi i saj do të varet krejtësisht nga Serbia.

Kjo është një marrëveshje ndërkombëtare bilaterale, e nënshkruar në mes të dy shteteve dhe sado që Kosova tash mund të mos pajtohet me fusnotën, ne ia kemi lidhur duart vetvetes me këtë marrëveshje, sepse pa dashur Serbia, fusnota nuk do të hiqet.

Pra, me pajtimin e dy palëve shkon kjo punë dhe nëse njëra palë nuk pajtohet, fusnota nuk do të mund të ndryshojë kurrë.

Pra, këta subjektivitetin e Kosovës, në njëfarë mënyre, e kanë lidhur me vullnetin e Serbisë deri kur një ditë, për shembull, Serbia e njeh pavarësinë e Kosovës. Kjo ditë jo që më duket e largët, por me sa po i shohim veprimet e Serbisë me këto armatosje të fundit dhe me një fushatë shumë aktive për ta kundërshtuar dhe minuar pavarësinë e shtetësinë e Kosovës, më duket krejtësisht një pikëpamje jorealiste, duke i parë ato që po ndodhin.

Çka po kërkon Lëvizja “Vetëvendosje”? Ne, shumë thjesht, po kërkojmë ta njohim vetveten. Kosova duhet të jetë shteti i 114-të që e njeh Republikën e Kosovës. Deri tash 113 shtete e kanë njohur Kosovën. Tash duhet edhe Kosova, dhe bëhen 114. Çka i bie kjo? Kjo i bie një deklaratë që ne së brendshmi nuk e njohim fusnotën. Fusnota mund të jetë për bashkësinë ndërkombëtare, fusnota mund të jetë për Serbinë, por Kosova nuk e njeh vetveten duke ia vendosur fusnotën vetvetes. Se kudo që shkon Kosova, e mban asteriksin dhe në ato nismat kur Kosova paraqitet me emrin e saj, duhet ta vendosë aty përpara emrit të saj fusnotën.

Pra, një zgjidhje do të mund të kishte qenë, pse të mos e vendosë Serbia fusnotën? Pra pse, nëse do Serbia të kallëzojë Kosovën, le ta shkruajë Serbia që nuk e njeh Kosovën. Po, pse ne ta shkruajmë se nuk po e njohim Kosovën, apo që ka dallime, do të thotë, është njëfarëloj dykuptimësie dhe ambiguiteti nëse Kosova është shtet apo nuk është shtet.

Pra, kjo ishte një zgjidhje skandaloze dhe ne u lodhëm më me këtë politikën: “Me rëndësi pjesëmarrja”. Kjo politika “me rëndësi pjesëmarrja” është shumë e rrezikshme.

Në anën tjetër, çfarë përfitimesh, diçka ekskluzive pati Kosova deri tash prej vitit 2011 në dialog me Serbinë me këtë politikën “me rëndësi pjesëmarrja”.

Po Kosova ka shtruar me miliarda e miliarda asfalt me para të veta, pa e marrë asnjë cent, as prej këtyre nismave rajonale, as prej Bashkimit Evropian, as prej kurrfarë institucioneve evropiane.

Kjo nuk i ka ndodhur as Rumanisë, as Sllovakisë, as Çekisë, as Hungarisë. Të gjitha këto shtete kanë thithur fonde e fonde, donacione të ndryshme për infrastrukturë për të gjitha këto, e Kosova krejt asfaltin e vet me para të veta e ka shtruar.

E që ta dini, asfalti është luks, në kuptimin e çmimit. Kur Hungaria shtron autostrada e asfalt me donacione të BE-së, Kosova qenka ai farë shteti i miliardave të pakufishme që i paska për t'i shtruar krejt me para të veta. Po kjo është skandaloze! Mos bëni zhurmë hiq, sepse skandaloze është kjo.

Kjo nuk i ka ndodhur asnjë shteti, as të Ballkanit e as të Evropës, kështu që, sa i përket kësaj, boll më me këtë politikën “me rëndësi pjesëmarrja” e po përfitojmë shumë, sepse përfitimet e Kosovës, për shkak të Qeverisë së papërgjegjshme, janë minimale dhe nuk po i shohim askund.

Dhe, e fundit që dua të them, është se mua më kujtohet kur e patët lidhur këtë “koalicionin e elefantëve”, si po i thoni. Arsyeja ka qenë se i keni 86 vota dhe nuk keni më nevojë t'i luteni opozitës hiq!

Tash, çka po ndodhin gjithë këto lutje, gjithë këto përgjërime? Nëse doni ta keni opozitën dhe votën e opozitës, duhet t'i dëgjoni kërkesat e saj. Kërkesa e vetme është: Ky Kuvend duhet ta lëshojë një deklaratë se Kosova nuk e njeh në aspektin e brendshëm fusnotën.

Nëse e bëni këtë, do t'i keni votat dhe do të bëhet shumë mirë, po edhe ai Fondi perëndimor i Ballkanit, edhe kjo nisma për rininë dhe të gjitha këto të tjerat.

KRYESUESI: Ministri e do fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Unë dua të lus shefin e Grupin Parlamentar, zotin Zenun Pajaziti, se më duhet të flas para tij dhe pa u koordinuar me të, por Partia Demokratike e Kosovës e mbështet apo e voton një deklaratë të tillë, e që ju duhet ta miratoni në Kuvend se Kosova nuk e njeh fusnotën dhe na i jepni votat për Fondin për Ballkanin Perëndimor.

(Ndërhyrje)

Ju na i jepni votat! Ishte propozim juaji. Unë i kërkoj falje Zenunit dhe të gjithë deputetëve, por PDK-ja, po flas si zëvendëskryetar tash i PDK-së, PDK-ja pra voton për, formulojeni sot tekstin dhe na e jepni votën për Fondin e Ballkanit Perëndimor dhe e çojmë selinë në Tiranë.

(Ndërhyrje)

S'e paskam dëgjuar. I kërkoj falje! Por, pajtohem plotësisht me zotin Glauk Konjufca se ne nuk mjafton vetëm të marrim pjesë, sepse edhe unë jam i lodhur nga pjesëmarrja. Por, ka pasur edhe hapa konkretë.

Vitin e kaluar ne kemi marrë një projekt për modernizimin e hekurudhës, dhe ministri Hoti mund t'ju informojë në detaje, që ka qenë nga 3 projektet e Samitit të fundit në Paris, që ministri Hoti, Zharku dhe unë kemi lobuar për muaj të tërë dhe është nga 3 projekteve ose 2 projekte të vetme që i ka marrë realisht Republika e Kosovës. Kështu që në të ardhmen duhet të koncentrohemi, e ndoshta ju do të kërkonit llogaridhënie edhe më të madhe nga ne se çka të bëjmë me energjetikë, çka të bëjmë me rrugë të reja, sepse është vërtet e kotë, në vitin e nëntë të flasim vetëm për anëtarësim në organizata, ose atë që e tha zonja Osmani, të kemi seli të organizatave këtu, por jo pjesëmarrje.

Përtej kësaj, dua t'ju them diçka kështu goxha edhe politike dhe njerëzore. Ju po flisni se çka është e drejtë, e unë po flas si ministër i Jashtëm se çka është e mundshme. Politika e jashtme ndërton dy parametra: çka është e drejtë dhe çka është e mundshme, juve ju takon.

Prandaj bëni deklaratën, e miratojmë që Kosova brenda nuk e njeh Kosovën, po flas si ministër i Jashtëm dhe si anëtar i Kryesisë së PDK-së, na e jepni votën një herë. E keni fjalën time të nderit se ne e votojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lutem, dy fjalë dua t'i them për këtë debat.

Debati po largohet shumë nga tema, unë e di që ju do të thoshit që çdo gjë është e lidhur me çdo gjë dhe është e vërtetë, me nga një fije gjithçka me gjithçka është e lidhur. Por askush nuk ua ndalon juve që ta thirrni ministrin e Jashtëm, Hoxhaj, në interpelancë. Mund ta thirrni të bisedoni për politika të jashtme të Qeverisë, edhe të Ministrisë së Jashtme. Askush nuk e ndalon as ministrin që të bëjë bisedime në Kuvend kaq shteruese qysh po i bën sot dhe unë ju propozoj ta bëni tjetër herë, t'i kthehemi çështjes, e kemi një ligj konkret, një marrëveshje ratifikimi.

Pra, unë do t'ua jap fjalën të gjithëve që e kanë kërkuar, edhe po ua them edhe emrat se po shtohen herë pas here, domethënë për replikë është Vjosa Osmani, sa kuptoj për replikë Demaku, sepse ka folur dhe janë, Zafa e preku tash, edhe Zafa nuk di pse, një herë ka folur, Faton Topalli, Ismajl Kurteshi, Ilir Deda nuk ka folur, domethënë e merr fjalën zonja Osmani, Puhije Demaku pas saj.

Po, të lutem, Vjosa, për çështjen sa më ngushtë.

VJOSA OSMANI: Po, po, për çështjen, natyrisht.

Ratifikimi i këtyre marrëveshjeve nuk i siguron Kosovës vetëm pjesëmarrje, i siguron Kosovës zë dhe mundësi që të marrë pjesë në projekte, të cilat në shumë raste, si për shembull, çështja e transportit janë projekte multimilionëshe. Pra, përfitimet janë të shumta në qoftë se Qeveria e kryen punën e vet. Unë nuk e di a do ta kryejë apo jo, mirëpo në qoftë se e kryen punën e vet, atëherë përfitimet për qytetarët e Kosovës nuk janë vetëm një ulëse në këto nisma rajonale, por janë të shumta dhe janë kryesisht investime në infrastrukturë dhe në fusha të tjera.

Fusnota kurrë nuk është ratifikuar në këtë Kuvend. Modele ka të mira mjaft, për shembull, modeli i Maqedonisë që u përmend, ku një deklaratë, e cila tregon që ne veten e njohim si Republikë e Kosovës mund t'i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje dhe përnjëherë të votohen.

Modeli tjetër është ajo që është bërë me propozimin e zotit Deda në MSA, ku në tekstin e projektligjit, pra neni 1, ne i adresohemi vetvetes si Republikës e Kosovës, e jo si Kosovë me fusnotë, sepse në ligj të Kosovës nuk kemi ne nevojë t'i referohemi vetvetes me fusnotë. Mirëpo, tekstin e marrëveshjes që është nënshkruar nuk mund ta ndryshojmë, ajo ose ratifikohet, ose nuk ratifikohet.

Pra, ajo që është me rëndësi është që tash të merremi vesh për dy paragrafë, mundemi këtu për 5 minuta të dakordohemi për tekstin, dy paragrafë se si e njeh Kosova vetveten. Për shembull, edhe Maqedonia marrëveshjet i ratifikon si FYROM, mirëpo pastaj në parlament i bashkëngjitet një deklaratë, ku i referohen vetvetes si Republikës e Maqedonisë.

Pra, modelin e ngjashëm një deklaratë të tillë dhe pastaj ndoshta si gabim teknik mundet, në qoftë se është bërë, mundet edhe administrata si i është referuar ligjit me Republikë të Kosovës sipas modelit të fusnotës në tekstin e ligjit te neni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Puhije Demaku e ka fjalën.

PUHIJE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Është goxha e pandershme nga ana juaj, zoti ministër, që një propozim, të cilën e kemi shtruar në Kryesi e Kuvendit të Kosovës, edhe unë e ceka në fjalimin tim, prandaj është e pandershme që në fund të nxirret pas një debati shumë të ashpër këtu të dalim me diçka që qenka në rregull ta bëjmë një deklaratë të tillë.

Deklarata është propozuar si konsensus politik i këtij Kuvendi që ne të mund ta hapim rrugën. Askush nuk po i konteston përfitimet dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në këto nisma, askush nuk i ka kontestuar deri më sot, po ne i kemi kontestuar se a ia vlen barra qiranë, a ia vlen çmimi, të

cilin po e paguajmë me heqje dorë nga subjektiviteti ynë për të marrë pjesë për të përfituar nga këto fonde, ky ka qenë kontestimi.

Po unë dua edhe një herë një qartësim nga ju. A po e tërhiqni fjalën që ia keni thënë Edi Ramës: “Mos u përzhini në punë të Kosovës”, me që selia është tash në Tiranë? Po insistoni që qenka shumë e mirë selia në Tiranë.

KRYESUESI: Urdhëro, ministër, sa të doni do të bëni replikë.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Unë ju kërkoj falje se nuk e kam dëgjuar propozimin tuaj, nuk e kam ditur që është në Kryesi, ju them me sinqeritetin më të madh.

Ju kisha lutur të më kurseni prej pikëpamjeve që i kam nganjëherë për shpejtësinë e Edi Ramës në raport me Beogradin, i kam thënë publike, mund t’i them edhe në të ardhmen.

E di që qytetarët e Kosovës e çmojnë Edi Ramën, e çmojnë Shqipërinë dhe është mirë që e donë edhe Edi Ramën, e çmojnë edhe Shqipërinë, edhe unë kam respekt të madh, është kryeministër, po kësaj here nuk dua të flas, por çfarë dua të them është kjo.

Nëse Kuvendi i Kosovës e bën një deklaratë të tillë, e marrëveshja e cila është nënshkruar për asteriksin, është marrëveshje ndërkombëtare. Unë e di se në çfarë territori jam duke lëvizur, në këtë deklaratë të tillë të Kuvendit të Kosovës e çojmë në çdo organizatë të mundshme, që ta informojmë çdo organizatë të mundshme rreth deklaramit tuaj se si e shihni ju raportin me këto organizata.

Veç dola të them se unë nuk e kam ditur që ka qenë propozimi juaj i kahershëm. Kur e dëgjova zotin Konjufca, m’u duk që ju po kërkonin një të drejtë, ndërsa mua më duhet ta shtyj një të mundshme. Kështu që ju kisha ftuar edhe një herë, sepse dola që 5-6 herë, ju kisha ftuar edhe një herë: votoni marrëveshjen dhe bëni deklaratën! Ju vendosni.

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar Ilir Deda.

ILIR DEDA: Faleminderit! Mua po më duket thua se është hera e parë që ne jemi para një marrëveshjeje ndërkombëtare, të cilën Kuvendi e ka ratifikuar, ku Kosova e ka nënshkruar si fusnotë.

Ka pasur praktika në të kaluarën, e është vërtetuar edhe me Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, kur ligji ynë e ka pasur emrin: “Ratifikohet Marrëveshja për Stabilizim-Asociim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”.

Me të drejtë ndërkombëtare, ne e kemi ratifikuar si shtet dhe askush nuk e konteston atë. Domethënë, kjo praktikë ekziston, mundet edhe në këto dy pika të njëjtë të ceket: “Ligji i Republikës së Kosovës për ratifikimin e Marrëveshjes për Fondin e Ballkanit Perëndimor” dhe pjesa tjetër për Zyrën rajonale dhe nuk ka asnjë arsye për t’u diskutuar. Po më vjen shumë keq, po propozimi që ta bëjmë ne tash në një deklaratë është kot dhe është qesharak, të mos u hyjmë gjërave, të cilat nuk po i dimë mirë, për populizëm, se nuk është në rregull. Thjesht, sepse kështu e keni bërë edhe me MSA-në, s’e keni votuar, e merrni pjesë në Komision të MSA-së, e tash thoni: “Ne s’e kemi votuar MSA-në, po marrim pjesë aty”. A e dini qysh, duhet të jemi konsistentë për neve si ligjvënës, edhe si Kuvend është me rëndësi që ligjet të jenë të Republikës së Kosovës, ashtu qysh e kërkon Kushtetuta, qysh e kemi votuar MSA-në e qysh i kemi votuar dokumentet e mëparshme, edhe përfundon debat, përfundon frika çka po ndodh me shtetësinë tonë?

Çka ka me “Republikës së Kosovës...” a në faqe të parë në ligj, në rregull jemi me Kushtetutën, në rregull jemi me shtetësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk e di, ju e lexuat listën e emrave kush ka për të folur në fund, unë kam qenë i treti në listë në fillim, nuk e di pse kanë folur edhe nja dhjetë të tjerë, sidoqoftë nuk ka rëndësi.

KRYESUESI: Faton, veç një moment, le, fjalën e more kur të erdhi rendi, shokët dhe shoqet tuaja po bëjnë replika shumë. Ata donë replikën, u kam dhënë replikat, të kanë shtyrë ata, kështu që, urdhëro!

FATON TOPALLI: I treti kam qenë në radhë, po s’ka rëndësi.

Po i kthehem temës për të cilën po diskutojmë dhe në kuptimin e vlerave të përgjithshme unë s’kam asnjë problem sa i përket marrëveshjes, sa i përket bashkëpunimit, forcimit të lidhjeve, integritit në Bashkimin Evropian, prezantimin e përbashkët, e kështu me radhë, pra nuk kam asnjë vërejtje në këtë çështje.

Nuk e shoh problematik themelimin e fondit. Sa i përket fusnotës, foli kolegja Puhije Demoku. Dua vetëm të shtoj këtë dhe u përmend shumë kjo çështja e fluskës së Edita Tahirit dhe duhet të them që kjo farë fluska e Edita Tahirit, respektivisht kësaj fluske po i vjen era gjithmonë e më shumë dhe mendoj që duhet të organizojmë një debat sa i përket fluskës së Edita Tahirit.

Atë që nuk e tha deri më tash askush është që para disa ditësh në këtu në Kuvend kemi sjellë një vendim që të pezullohet bashkëpunimi, bisedimet me Serbinë.

Në mënyrë indirekte ky lloj bashkëpunimi po vazhdon edhe tani nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, të cilën po thonë se do ta firmosim sot.

Pra, nga njëra anë, kemi deklaruar si Kuvend që nuk bisedojmë, nuk bashkëpunojmë me Serbinë derisa të lirohet Ramush Haradinaj dhe në të njëjtën kohë po dëshirojmë të hyjmë në organizata të përbashkëta.

Në fund edhe diçka sa i përket asaj që tha zoti Enver Hoxha që konteksti ndërkombëtar për Kosovën po ndryshon, kjo është, në fakt, e vërtetë.

Keni filluar t'i prishni marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian, me NATO-n. Ajo që dua të them është që konteksti ndërkombëtar ka ndryshuar qëndrimin ndaj PDK-së, por jo ndaj Kosovës dhe nëse ka ndryshim, ky ndryshim vjen pikërisht për shkak të dështimit të diplomacisë së Kosovës si në raport me Bashkim Evropian, si në raport me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur për 9 vjet me radhë nuk i keni arritur të bindni as për të na njohur pavarësinë e plotë, as për t'i bindur disa shtete të Bashkimit Evropian që ta njohin shtetin e Kosovës dhe të hiqet fusnota, as të krijojnë raporte të tilla, ku çështja e ushtrisë së Kosovës nuk do të duhej as të diskutohej.

KRYESUESI: Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Me që sot po diskutojmë për dy marrëveshje të rëndësishme, e që shumica e parafolësve me të drejtë thanë se nuk është zgjidhje as izolimi i Kosovës, por njëherësh nuk është zgjidhje as votimi i këtyre marrëveshjeve me fusnotë, mendoj që zgjidhja tanimë është propozuar se duhet të bëhet një deklaratë, me të cilën ne deklarojmë se për ne fusnota është e papranueshme, se ne në Kosovë kemi vetëm një alternativë, Republikën e Kosovës dhe kërkoj nga ju, zoti kryesues, të na jepni një pauzë, të bëhet ajo marrëveshje, të shkruhet ajo deklaratë dhe pastaj t'i votojmë këto ligje, sepse zgjidhje tjetër nuk mund të ketë më racionale sot se sa kjo.

Mendoj që një deklaratë e tillë, e cila përdoret edhe në vende të tjera, është më se e domosdoshme dhe aspak për t'u qeshur me të, po për ta marrë shumë seriozisht. Faleminderit!

KRYESUESI: I fundit i paraqitur Zafir Berisha, edhe i thërras deputetë, edhe regjia le t'i thërret deputetët të vijnë në sallë.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

U inspirova edhe një herë të marr fjalën, sepse u dëgjua shumë politika të mëdha, fjalë të thata pa mbulesë ose fjalime, të cilët dështimin e politikës së jashtme tentuan ta mbulojnë.

Shpesh u tha këtu se po tregohemi të papërgjegjshëm, në rast se nuk votohet, jemi të papërgjegjshëm.

Unë po mendoj se duke mos votuar jemi të përgjegjshëm, sepse ruajmë substancën e shtetit, e cila është vënë në pikëpyetje nga politika e papërgjegjshme në raport me marrëveshjet që janë bërë me Serbinë në Bruksel.

U diskutua e u stërdiskutua deri atje sa u tha se e dimë çka është e drejtë, por ne jemi të detyruar të bëjmë atë që është e mundshme.

Shtrohet pyetje pse të vijë Kosova në këtë situatë që të bëjë atë që është e mundshme, kur ka mundur të bëjë atë që është e drejtë.

Natyrisht u derdh dhe u vajtua shumë mosprania në një fond rajonal.

Unë mendoj se më shumë duhet të vajtohet që Kosova po pëson regres, domethënë në politikën e jashtme dhe po dëmtohet imazhi i Kosovës se sa të jesh me një fond, i cili, për mendimin tim, nuk është aq substancial sa është substanciale ruajtja e identitetit shtetëror kudo që prezantohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: A bën të ulen deputetët?

Kolegë deputetë, me kartela ju shenjoheni që jeni 96 vetë, në numër nuk jeni, kështu që ata që i kanë ato kartela, hiqni.

Në sallë janë 90 deputetë.

Ju lutem, një prezicim të shkurtër, para se të hyjmë në votim.

Ju e dini që për këto marrëveshje duhet të marrin pjesë mbi 80 deputetë dhe të votojnë për 80 deputetë. Ju lutem, a janë 90 deputetë?

Pra, kolegë deputetë, në sallë janë të pranishëm... unë e udhëheq mbledhjen, dhe shijet tuaja e diskutimet u kryen, ka mbaruar diskutimi.

Deputetë të nderuar, dëgjoni formulimin që propozoj unë për ligjin në titull.

Propozoj që të votohet prej të gjithëve dhe formulimin e propozoj sipas Marrëveshjes së Stabilizimi-Asociimit, në të vërtetë variacionin që e propozoi Ilir Deda të thuhet: "Të miratohet projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes nga Republika e Kosovës përkritazi me themelimin e

Fondit të Ballkanit Perëndimor”. Tjetër këtu nuk mund të bëjmë sot, çfarëdo variacione për raporte të Kosovës me të tjerët në rajon, në botë, në Evropë, nuk bëhen me një diskutim që lidhet me një problem tjetër brenda dite. Ato janë procedura që kërkojnë konsultime, paraqitje, regjistrime, e të tjera.

Atëherë ju thërras të gjithëve që ta votojmë, edhe regjinë. Votojmë tash!

Faleminderit! Votimi mbaroi, kanë votuar 81 deputetë, për kanë votuar 70, kundër 2, kanë abstenuar 9. Nuk kalon, dihen procedurat qysh bisedohet me Qeverinë tutje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit numër 05/L-149 për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për bashkëpunim rinor në mes të Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport e tjera e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

E ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë e Sport, zotin Kujtim Shala, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Urdhëro, Zenun.

ZENUN PAJAZITI: Kryesues, po e dua fjalën dhe besoj që të jemi sa më korrektë dhe të dëgjohe mi. Mendoj që nuk duhej të kalohej ashtu pika që sa e votuam, votimin sa e bëme.

Mendoj që kishte propozime, kishte një dakordim që grupet parlamentare të ulen, të harmonizojnë një deklaratë që do të mund të votojnë bile në bllok me të gjitha këto propozime që të vijnë dhe do të ishte në të mirë të ratifikimit të këtyre marrëveshjeve që janë në interes të vendit tonë.

Mendoj që përpilimi nuk do të mund të bëhej vetëm nga një deputet, pavarësisht që edhe unë pajtohem shumë me zotin Deda, por duhet të kemi durimin e duhur sot që të bëjmë një pauzë nja 15 minuta, të dakordohemi që një deklaratë me 2-3 fjali, hiç më shumë, t'i paraprijë një vendimi të përbashkët për t'i votuar këto marrëveshje që janë në interes për vendin tonë.

Mendoj që ndoshta nuk do të ishte mirë që të kishim kaq debat të zgjatur sot, por se në rrethana të sotme është një vullnet i të gjitha grupeve politike dhe ne duhet ta shfrytëzojmë në të mirë të nënshkrimit të ratifikimit të këtyre marrëveshjeve.

Kërkoj, zoti kryesues, mirëkuptimin që ta kemi këtë mundësi sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë kam mirëkuptim për ju çka doni vendosni ju, mirëkuptim të pafund, po ju diskutuat për dy orë, jo unë, dhe ju nëse doni të krijoni një dokument, është në dorën tuaj, nuk është në timen, po edhe një herë po ju them mos ikni në tema të gjithë historisë politike të Kosovës, se ajo do kohë. Problemet janë themelore, janë marrëveshje ndërkombëtare, të gjithë po thonë që keni brena të mëdha për qytetarë e për interes të Kosovës, hajde pra, bëni këtë brenë në vepër, me votë.

Kërkoj mendimin e LDK-së për propozimin.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar! Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike pajtohet me propozimin e zotit Zenun Pajaziti që të kërkojmë një pauzë prej minutash, të dakordohemi me të gjitha grupet parlamentare dhe ta harmonizojmë atë rezolutë për miratim.

KRYESUESI: E dua mendimin e “Vetëvendosjes”.

GLAUK KONJUFCA: Po, është më se e arsyeshme që të ketë një votë të përbashkët të pozitës dhe të opozitës për këto marrëveshje, duhet të ketë një konsensus për një deklaratë, e cila duhet të formulohet. Ajo shkruhet shumë shpejt në bashkëpunim, tash do të takohemi me njëri-tjetrin dhe mund ta nxjerrim një tekst të shkurtë sa i përket qëndrimit të parlamentit për fusnotën.

KRYESUESI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës?

RRUSTEM BERISHA: Edhe ne si subjekt e përkrahim një iniciativë të tillë që të ulemi dhe të dakordohemi për një deklaratë të përbashkët.

KRYESUESI: Haxhi Shala, për “Nismën” e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Edhe ne si subjekt e përkrahim këtë iniciativë, edhe pse e vonuar, ne do ta përkrahim, sepse është në shërbim të interesit tonë, të diskutohet në lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Qerim Bajrami, nga “6+” e ka fjalën.

QERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući, I Parlamentarna grupa “6+” je za to da se sedne i napravi dogovor i da se ovi sporazumi izglasaju što je najvažniji. Hvala!

KRYESUESI: Të tjerë nuk ka të paraqitur.

Atëherë unë sa dëgjova, ju propozuat me një litodë, se nuk po e njihni fort vetveten që për 15 minuta e kryeni këtë punë. Unë e di që s'e kryeni. Kështu që sido që të jetë, unë ju jap këtë shans, nën një.

Nën dy, keni kujdes, ne kemi punë të tjera, këto janë që i kërkojnë 80 vota, kemi ligje të tjera. Unë mendoj që ne duhet të vazhdojmë punën, të mos mbetemi në kohën që do ta harxhoni ju për ta ndërtuar atë tekst që po e propozoni, nëse mundeni sa më shpejt, edhe më mirë, por të mos kushtëzohet seanca e sotme me atë formulim, sepse këto janë ligje specifike.

Ne kemi ligje në lexim të parë e të dytë që s'e kërkojnë këtë. Prandaj, deri sa të merreni vesh, unë po ju jap 15 minuta, pas 15 minutave ne vazhdojmë punën, sido që të jetë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Kolegë të nderuar,

Po vazhdojmë punën. Ju lutem, uluni!

Në sallë janë të pranishëm 82 deputetë. Atëherë ju njoftoj që 6 grupe parlamentare: PDK, LDK, Lëvizja "Vetëvendosje", AAK, "Nisma" dhe "6+" janë pajtuar dhe e kanë hartuar bashkërisht një deklaratë që do të votohet në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

E thërras deputeten Vjosa Osmani që ta lexojë deklaratën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Pra, me qëllim që marrëveshje të tilla që janë në interes të Kosovës të shprehin edhe vullnetin e qartë të Kuvendit të Kosovës, që Kosovën e njeh vetëm sipas emrit të saj kushtetues, gjashtë grupet parlamentare, që ju i përmendët, janë pajtuar në tekstin e kësaj deklarate, e cila pastaj do t'i bashkëngjitet secilës marrëveshje ndërkombëtare që ratifikohet në këtë Kuvend.

D e k l a r a t ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e njeh Kosovën vetëm në bazë të emrit të saj kushtetues si Republikë e Kosovës,
2. Në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen me ligj që i referohet Kosovës sipas emrit të saj kushtetues, dhe
3. Kjo deklaratë do t'i bashkëngjitet secilës marrëveshje ndërkombëtare, e cila ratifikohet në Kuvend nga sot e tutje.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Osmani!

Deputetë të nderuar,

E thërras regjinë të bëhet gati, votojmë për deklaratën e posalexuar në marrëveshje nga gjashtë grupe parlamentare.

Momentalisht këtu janë 85 deputetë. E hedh në votim deklaratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Votojmë tash!

Faleminderit! Votimi është kryer, edhe një është që s'ka kartelë që po voton me ngritje dore, është Zafiri. Domethënë, 86 deputetë kanë votuar.

Janë 101 kartela, harrojini kartelat, numëroni personat! Të pranishëm janë 86 deputetë. 1 është pa kartelë, apo vetëm Zafiri? Ju lutem regjia, votojmë tash!

Kanë votuar 86 me kartelë, 1 pa kartelë.

Kanë votuar 85 deputetë, për kanë votuar 80, kundër 5, abstenim s'ka. Aprovohet deklarata e Kuvendit.

Atëherë, ju lutem dëgjoni, meqë ne votuam herën tjetër për ligjin e parë dhe ju e dini se nuk kaloi, unë kërkoi një pëlqim formal me ngritje dore që t'i rikthehen edhe këtij ligji edhe të votojmë edhe një herë. Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka!

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

E kemi shteruar bisedën rreth këtij ligji. Ju lutem bëhuni gati votojmë tash.

Faleminderit! Kanë votuar 91 deputetë. Për janë 89. Kundër janë 2.

Kuvendi e miratoi Ligjin Nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë E ftoj ministrin e Kulturës ose ministrin e Jashtëm që ta paraqesë ligjin. Urdhëro, zoti Hoxhaj!

MINISTRI ENVER HOXHAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Edhe këtë projektligj e keni pasur edhe një herë në shqyrtim, besoj që përmbajtja e këtij projektligji është e njohur për të gjithë për ju, por ky projektligj është derivat apo është pasojë e procesit të Berlinit nga viti 2013, ku qëllimi bazik i projektligjit është që nëpërmjet një marrëveshjeje ndërqeveritare të vendeve të ndryshme të rajonit të themelohet një qendër, e cila do të duhej ta ndihmojë rininë e rajonit që të bashkëpunojë në fusha të ndryshme të jetës dhe ndër fokuset e bashkëpunimit duhet të jetë edhe ideja e pajtimit ndërmjet popujve të Ballkanit. Po ashtu, selia e kësaj organizatës sikur e para do të duhej të vendoset në Tiranë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi ose kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni, më 20 janar 2017, e ka shqyrtuar këtë projektligj edhe i rekomandon Kuvendit për miratim të këtij projektligji për shkak se i plotëson të gjitha kushtet ligjore.

KRYESUESI: Faleminderit! Nëse doni deklaratat në emër të grupeve, Vjosa Osmani, Teuta Haxhiu...

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Pak a shumë me votimin e deklaratës, që do të kishte qenë mirë të ishte rezolutë e Kuvendit, u pajtuam paraprakisht, mirëpo i kisha lutur përgjegjësit, në këtë rast Ministrinë e Kulturës që vërtet brenda kësaj marrëveshjeje që është në interes, në radhë të parë të rinisë, të jenë përfaqësues të Republikës së Kosovës njerëz profesionalë, jo partiakë dhe të punohet në interesin e vendit, e të mos punohet në interes të subjekteve politike.

Prandaj, në këtë frymë, ne e thamë pak më herët me votimin e asaj deklarate që thashë kishte qenë shumë më mirë të jetë të paktën rezolutë, edhe pse Kuvendi ka treguar që nuk ka qenë serioz në shikimin se sa janë zbatuar rezolutat e Kuvendit, edhe kjo konsideroj se do të shkojë sikur rezolutat e tjera, por formalisht ndoshta e marrin një fletë me vete kur shkojnë, edhe ministri i Punëve të Jashtme, por edhe ministrat e tjerë, të paktën në materialet e veta, e se sa e prezantojnë është krejt diçka tjetër.

Pra, edhe një herë: të mos tentohet që personat që do të jenë brenda kësaj marrëveshjeje që do ta prezantojnë Kosovën në zyrën në Tiranë, që nuk është krejtësisht e mjaftueshme, të jenë profesionistë, e jo partiakë.

KRYESUESI: Faleminderit! Qerim Bajrami për Grupin “6+”.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

S obzirom da grupa "6+" imala primedbu na Komisiji za obrazovanje, kulturu i sport, da u ovom sporazumu fali jedna riječ ili rečenica, a to znači da među ovim predstavnicima omladine sa Kosova trebaju da budu zastupljeni i pripadnici nevećinskih zajednica.

Nema tamo ni polne ravnopravnosti, nažalost ta preporuka nije usvojena ispred naše grupe i Parlamentarna grupa "6+" će glasati protiv ovog sporazuma.

KRYESUESI: Të tjerë nuk ka. Atëherë, ju lutem shumë, këta po deklarohen që s' do ta votojnë.

Në sallë janë 88 deputetë. Të tjerë nuk janë paraqitur që të flasin, unë ju thërras që ta votoni marrëveshjen. Regjia le të bëhet gati, votojmë tash!

A kush që është pa kartelë, që s' ka votuar? Një! Tjetër a ka? Atëherë, ne i kemi 91 votues, 90 me kartelë dhe 1 pa kartelë. Votojmë tash!

Kanë votuar 91 deputetë me kartelë dhe 2 pa kartelë, gjithsej 93. Prej tyre 79 deputetë kanë votuar për.

Atëherë a jeni të gatshëm tash të votojmë? Paraprakisht, kush nuk ka kartelë dhe dëshiron të votojë? Një. Tjetër? Domethënë, 1 nuk ka kartelë. Atëherë, ju lutem tash edhe regjisë bëhuni gati për votim. Votojmë tash!

Atëherë në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë me kartela dhe një pa kartelë, gjithsej 93. Për kanë votuar 82 deputetë, kundër kanë votuar 10, ka abstenuar 1.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-149 për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST sh. a. dhe operatorit të sistemit, të transmisionit dhe tregut-KOSTT sh. a.

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e projektligjit në një amendament.

Kërkoj nga ministri Blerand Stavileci që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Më lejoni të paraqes para jush për shqyrtim dhe miratimin Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, dhe Këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST dhe operatorit të sistemit të transmisionit KOSTT.

Kjo marrëveshje e përkufizon saktë bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet organeve përgjegjëse për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST dhe operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut KOSTT.

Objektiv kryesor është krijimi i zonës rregulluese, e me këtë edhe integrimi në mekanizmin regjional, i cili do të ndikonte në realizimin e tregtisë ndërkufitare, duke rritur kështu likuiditetin e tregut të energjisë elektrike. Kjo do të mundësonte zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet sistemeve energjetike të të dyja vendeve për t'i optimizuar kostot financiare dhe për ta rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike në përmbushjen e dispozitave ligjore të direktivave përkatëse të legjislacionit të BE-së si palë nënshkruese të traktatit të komunitetit të energjisë.

Prandaj, të nderuar deputetë, shpresoj që ky projektligj të gjejë mbështetjen dhe të aprovohet nga ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 10 të Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare, si dhe neni 60 të Rregullores së Kuvendit i ka rekomanduar Kuvendit që ta ratifikojë këtë marrëveshje ndërkombëtare në procedurën e paraparë.

Edhe komisioni e ka përshëndetur këtë marrëveshje, sepse i kontribuon optimizimit të dy sistemeve energjetike dhe furnizimit më cilësor me energji elektrike. Njëkohësisht, komisioni e ka një amendament për precizim të nenit 1, 2, 3 të këtij projektligji. Në fund të këtyre neneve duhet të shtohen fjalët “janë nënshkruar më 30. 3. 2016”. Gjithashtu, komisioni dëshiron të tërheqë vëmendjen dhe të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministria

përgjegjëse që t'i ndërmarrin masat adekuate me partnerin nga Shqipëria dhe ta ndërtojnë një protokoll për t'i krijuar kushtet lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Rekomandimi tjetër me rastin e aprovimit të këtij projektligji është që Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, t'i marrin masat për evitimin e pengesave nga Serbia lidhur me anëtarësimin e KOSTT-it në NENTIOSEI, që është një parakusht kryesor për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ne në komision e kemi ftuar ministren Tahiri që të raportojë për këtë problem dhe i kemi kërkuar me atë rast Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha subjekteve që të ndërmarrin masa proporcionale për mbrojtjen e interesave të Kosovës në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lutem, e kemi vetëm një amendament, unë ju tërheq vëmendjen që edhe amendamenti duhet t'i marrë 80 vota për.

Ju thërras që ta votojmë amendamentin numër 1. Regjia dhe deputetët votojnë tash!

Kanë votuar 91 deputetë, 91 vota janë për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Kalon amendamenti.

Atëherë, bëhemi gati ta votojmë ligjin bashkë me amendamentin e posavotuar. E votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash!

Kanë votuar 93 deputetë, 93 vota janë për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Kalon ligji.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST sh. a. dhe operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut KOSTT sh. a.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-157 për ratifikimin e marrëveshjes së financimit të Projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hoti, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Çështja që trajtohet me këtë projektligj është ratifikimi i Marrëveshjes së financimit të projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim. Vlera e përgjithshme e kësaj marrëveshjeje është 22 milionë euro me normë efektive të interesit 1.4% me greis-periudhë 5 vjet dhe 20 vjet kthim efektiv të kredisë.

Projekti është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë prej 15 milionë eurove dedikohet për përmirësimin e kanalit kryesor të ujit, duke filluar nga Ujmani deri në Obiliq. Me këtë pjesë të projektit parashihet të adaptohet edhe një sistem i avancuar elektronik, i cili do të mundësojë që Ibër-Lepenci të mbikëqyrë kanalin duke mbledhur dhe analizuar të dhëna nga terreni në kohë reale.

Ndërkaq, pjesa e dytë prej 7 milionë euro dedikohen për ndërtimin e një rezervuari të ujit në Mihaliq dhe lidhjen e tij me kanalin e ujit. Ky rezervuar do të shërbejë për situata emergjente.

Pjesa e kredisë për përmirësimin e kanalit do të nënshkruhet te ndërmarrja publike Ibër-Lepenci, kurse pjesa e dytë i mbetet Qeverisë për ndërtimin e rezervuarit. Procedurat për zbatimin e këtij projekti pritet të fillojnë sapo të ratifikohet kjo marrëveshje dhe ky projektligj në Kuvend.

Ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, të arsyetojë raportin e komisionit.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderua kolegë,

Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 18 dhe 93, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4 dhe paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-154 për marrëveshjet ndërkombëtare i ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së financimit të Projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje Qeveria e Kosovës huazon 22 milionë euro nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, nga kjo shumë 15 milionë euro do të huazohen për financimin e Projektit ndërtimi i kanalit të ujit, shumë kjo që do të menaxhohet tek ndërmarrja Ibër-Lepenci dhe 7 milionë euro që do të realizohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për financimin e projektit të ndërtimit të basenit të ujit apo rezervuari i ujit dhe lidhja e tij me sistemin e ujitjes.

Sa u përket kushteve të kredisë ato janë të volitshme, ku norma vjetore e interesit është 0,65%, tarifa vjetore e shërbimit është 0,75% dhe tarifa vjetore e zotimit është 0,5%.

Kthimi i kësaj kredie do të fillojë nga 15 tetori i vitit 2021 dhe do të fillojë më 15 prill të vitit 2042.

Ky kthim do të bëhet me 40 këste, që do të thotë nga dy këste për çdo vit.

Sa i përket ndikimit buxhetor, 15 milionë euro do të huazohen nga ndërmarrja Ibër-Lepenci, që do të mbulohen nga të hyrat vetjake të kësaj ndërmarrjeje, kurse 7 milionë që do të realizohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik nëpërmes klauzolës së investimeve.

Komisioni ka shqyrtuar marrëveshjen në fjalë dhe ka vlerësuar që kredia është e volitshme dhe i ka rekomanduar seancës, që ta votojë. Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së u rekomandojmë deputetëve që ta votojnë këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, fjalën e ka kërkuar Shqipe Pantina.

(Ndërprerje e incizimit)

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Natyrisht, se investimet që shkojnë në ndërmarrje publike, në këtë rast kjo kredi i dedikohet ndërmarrjes Ibër-Lepencit, janë të mirëseardhura, sepse shumë herë janë edhe të domosdoshme. Por, do të ishte mirë që para se të miratojmë kredi të tilla, të shohim se si po funksionojnë këto ndërmarrje, si i kanë menaxhuar fondet deri tash dhe në përgjithësi mënyra se si janë menaxhuar në tërësi këto ndërmarrje.

Për ndërmarrjen, për të cilën sot po japim kredi, ka pasur afërsisht disa prej të cilave janë të njohura edhe këtu, ta zëmë njëra është për blerjen e telefonave të mençur, që është bërë praktikë në shumë institucione tona.

E dyta, zoti ministër, ne kemi kërkuar nga Komisioni për Buxhet që të na sillni listën e të gjitha kredive të miratuara deri më tash. Vetëm këtë muaj ne kemi miratuar diku kredi në vlerë mbi 160 milionë euro e maturimi i këtyre kredive është mbi 20 vjeç, çka do të thotë se qeveritë e ardhshme, të paktën 5 prej tyre, do të vazhdojnë të paguajnë borxhet, për të cilat kjo qeveri e tashme i ka krijuar dhe duke u mburrur se buxheti ka shkuar në 2 miliardë.

Dhe nën 3, janë milionë euro të fondit FIPA, të cilat i ndanë Komisioni Evropian edhe për Kosovën e të cilat nuk po shfrytëzohen nga Qeveria, por edhe nga institucionet tjera.

Prandaj, para se ne të hyjmë në borxhe tjera me investime të cilat janë më se të domosdoshme, do të ishte mirë që Qeveria të hartonte projekte dhe të thithte grande nga BE-ja, në vend që ne të hyjmë në kredi dhe të paguajmë nga Buxheti paratë të cilat ne shumë mirë do të mund t'i

dedikonim në fushat tjera, siç është arsimi apo shëndetësia dhe të tjera, e që janë më se të domosdoshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besim Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë nuk kam ndonjë dilemë në duhet ta votojmë ligjin në fjalë apo nuk duhet ta votojmë, por ndoshta është bërë një lëshim teknik në kuptimin të emrit të ligjit, sepse po thotë: “Për mirëmbajtjen e kanalit” pa emër. Cilin kanal? A e keni fjalën vetëm për Ibër-Lepencin apo i përfshinë krejt kanalet e ujit në Kosovë?

Si emër, besoj se do të duhej të jemi pak më të fokusuar te ligji dhe të koncentrohemi që kur të hartojmë ligje, të jenë të sakta ato, jo veç për mbrojtjen e sigurisë së ujit dhe për mbrojtjen e kanalit... nuk e përcakton ligji se për cilin kanal është fjala. Në brendi mund të jetë e shpjeguar, por si tekst që e kemi këtu besoj se ka mangësi, që duhet ta përmirësojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, Muhamet Mustafa e ka kërkuar fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Vetëm dëshiroj të shpreh një mendim timin lidhur me diskutimet që u bënë këtu për hyrjen borxh për investimet afatgjata për infrastrukturë.

Unë mendoj se ky Kuvend duhet të mbështesë investimet në infrastrukturë edhe me hua afatgjata me norma të volitshme interesi, sepse vetëm kjo gjeneratë sot nuk mund të ndërtojë objektet të cilat do t'i shfrytëzojnë shumë gjenerata në të ardhmen. Prandaj, kjo edhe në aspektin ekonomik edhe social është plotësisht me vend.

Natyrisht, se ne duhet të kemi kujdes që mos të ngarkohemi tepër me borxhe, por sa di unë, deri më tani Kosova është larg ngarkimit të tepërt me borxhe, por secilin projekt, kuptohet, ne kemi thënë duhet ta shoqërojë studimi i fizibilitetit dhe përfitimet ekonomike dhe sociale.

Pra, mendoj se kjo Qeveri ka bërë diversifikimin e burimeve të financimit të objekteve të tilla afatgjata, të cilat do t'i shfrytëzojnë disa gjenerata, të kuptohemi. Kjo është e para.

E dyta, plotësisht pajtohem që ne të kemi një informatë të shpejtë, se sa po i shfrytëzojmë fondet e IPA-s, sa janë duke u shfrytëzuar, a ka probleme dhe projekte për shfrytëzimin e këtyre fondeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Daut Haradinaj e ka kërkuar fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Ndoshta profesori e keqkuptoi, ishin dilemat tek deri diku abuzimi i këtyre mjeteve dhe natyrisht, se nuk ka shumë transparencë, sidomos në këto organizata, që pothuajse janë shumë, shumë shpenzuese të buxhetit dhe nuk është vetëm Ibër-Lepenci, por ka shumë organizata që nuk dihet kurrë se kujt i raportojnë.

Është një keqpërdorim i skajshëm pothuajse në të gjitha, nuk është tema këtu vetëm për borxhet publike, në to që po hyjmë, mirë do të ishte ministri të na tregojë a janë duke u bërë këto me ndikime politike dhe a është gjithpërfshirja e Kosovës në këto kredi të buta, që po merren. A ka logjikë që ju mund ta refuzoni ndonjë ofertë për një kredi të butë në një zonë të caktuar, të cilën nuk po e sillni në Kuvend. Nuk po hyj në detaje, besoj që jeni i informuar se për çka e kam fjalën, por gjithsesi që do të ishte mirë me qenë transparentë, ku po shkojnë këto mjete, sa është huaja, sa është kamata, sa është afati i kthimit...? Do të ishte me rëndësi, besoj, aq më tepër kur kemi raste, për shembull, që ka pasur kredi të buta në nivelet komunale, ku nuk dihet se a është Qeveria e Kosovës ajo që i kthen mjetet, a është komuna, kuvendi komunal, a janë të hyrat vetjake të një komuniteti të caktuar në komunë apo janë obligime të Qeverisë së Kosovës, më saktësisht të Ministrisë së Financave.

Do të thotë, është mirë me dhënë një shpjegim pak më të saktë, se çka po votojmë. Unë jam shumë dakord që Kosova ka nevojë për të investuar në infrastrukturë, aq më tepër kur këto kredi të buta, ndoshta në këto rrethana, ky buxhet duket i madh, por pas njëzet vjetësh vlera e tyre nuk është e njëjtë. Sido që të jetë, mirë do të ishte të na informoni më mirë, kujt i raportojnë më së pari këto, për shembull Ibër-Lepenci kujt i raporton për shpenzimet e financave, nëse u fol për smart-telefone, a ku di unë... Po, ka shumë, për shembull, emëtime të anëtarëve të bordeve, punësime familjarësh, e të gjitha këto po shkojnë... nëse i shikoni, gjysma e deputetëve këtu i kanë familjarët e vetë të punësuar.

KRYESUESI: Ministri i ka dy fjalë.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Më lejoni të jap disa sqarime të shkurta.

Fondet IPA, është miratuar ligji që ka ratifikuar marrëveshjen për fondet IPA, para dy muajsh, nuk ka më shumë, ku rreth 70 milionë euro janë shpërndarë nëpër sektorë të ndryshëm. Tash, unë mendoj se gjatë këtij mandati kjo Qeveria ka bërë më të mirën të mundshme për të siguruar transparencë në shfrytëzimin e parasë publike.

Edhe me kërkesë të Komisionit Evropian ne kemi themeluar atë që është një si Këshill Kombëtar për Investime, ku janë ministrat kryesorë të resorëve që më së shumti ka investime në infrastrukturë, në arsim e në fusha tjera dhe janë të gjithë donatorët: Banka Botërore, Fonde

Monetar, bankat e ndryshme zhvillimore që punojnë në Kosovë, Komisioni Evropian dhe të tjerë...

Vijnë ministrinë dhe komunat me kërkesa për investime të ndryshme kapitale, shqyrtohen në këtë komision, nëse aprovohen nga ky komision, mandej neve na mbetet si Ministri e Financave të shikojmë mundësitë se kah do t'i financojmë ato projekte. Njëra prej marrëveshjeve, që besoj se po i referoheni tash, është marrëveshja për kredi të butë me Qeverinë e Austrisë, ku janë 11 komuna, që ne në parim i kemi aprovuar si projekte.

Tash është pala austriake, pra Ministria e Financave e Austrisë me kompani që e angazhon Qeveria e Austrisë për të bërë studimet e fizibilitetit për këto 11 komuna dhe varësisht prej progresit që bëjnë, ato marrëveshje mandej dërgohen në Ministri të Financave në Kosovë nga Ministria e Financave e Austrisë dhe në momentin që vijnë tek ne, ne procedojmë me procedurat tjera ligjore për të negociuar kushtet financiare, vetëm kushtet financiare sepse projekti aprovohet nga Ministria e Financave e Austrisë dhe bankat që i autorizon Ministria e Financave e Austrisë. Ne negociojmë kushtet financiare dhe i sjellim në kuvend për ratifikim.

Deri më tash, nga ajo kemi ratifikuar një marrëveshje në Ministrinë e Arsimit, një në Ministrinë e Shëndetësisë dhe janë disa të tjera, që janë në proces të finalizimit.

Pajtohem me deputetin Beqaj, se ndoshta është mirë të specifikohet titulli i ligjit, pra "kanali i Ibër-Lepencit". Dhe, të ju njoftoj që raporti për ndërmarrje publike, sepse po kërkon llogari për të, vjen në Kuvend të Kosovës për çdo vit. Unë besoj që ministri i Zhvillimit Ekonomik, së shpejti do ta sjellë tek ju dhe do të keni informata për secilën prej ndërmarrjeve publike për të hyrat, shpenzimet dhe kreditë që ka pasur, e tjera, e tjera... Nëpërmjet atij mekanizmi ju e mbikëqyrni punën e këtyre ndërmarrjeve publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E ndjeva obligim që ta bëj një sqarim shtesë për këtë projekt. Kam pasur rastin të jem për pesë vjet e gjysmë kryeshef ekzekutiv i kësaj ndërmarrjeje, deri në dhjetor të vitit 2014, kur kam dhënë dorëheqje për të ardhur deputetët në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket, këta e tha si përmirësim edhe zoti Beqaj, ministri e deputetit realisht, në atë kohë ishte ministër kur e kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë. Ne si menaxhment i ndërmarrjes publike, Bordi i ndërmarrjes dhe ministri Beqaj, në bashkëpunim me Bankën Botërore, ku është bërë një punë e mirë dhe i falënderoj nga këtu gjithë menaxhmentin e Ibër-Lepencit, po edhe Bankën Botërore edhe Qeverinë atëherë që kanë qenë në përkrahje të mirë për Ibër-Lepencin.

Kjo u tha te emri, u bë një përmirësim, që Kanali i Ibër-Lepencit është një kredi e butë, e cila garanton sigurinë e Kanalit. Ne e dimë, se kemi pasur raste edhe me humbje jetësh, nëpër fshatrat ku shtrihet kanali. Përmirësimi do të thotë edhe të skedave dhe është Liqeni i Mihaliqit, ku ka kapacitete 3 milionë m³. Ky kanal ka një rëndësi të veçantë, se nuk u sqarua ndoshta edhe shumë mirë, përveç ujitjes ka edhe furnizimin me ujë industrial edhe Kosovën A, Kosovën B dhe projektin Kosova e Re, e furnizon me ujë industrial pa përpunuar edhe fabrikën e porsahapur tash në Shkabaj për Prishtinën dhe për shtatë komuna të tjera. Në të njëjtën kohë furnizon me ujë industrial edhe Ferronikelin. Është kanal i rëndësishëm së veçantë, është edhe kanal alternativ për furnizimin e Liqenit të Badovcit, në raste të veçanta.

Unë edhe një herë ju falënderoj dhe konsideroj se është një marrëveshje e mirë dhe një kredi e mirë për një projekt shumë të rëndësishëm për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lutem, nuk ka të tjerë që kanë shprehur dëshirë të flasin.

Ma jepni numrin e deputetëve. Atëherë, bëhuni gati që ta votojmë Projektligjin për ratifikim.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati! Votojmë tash!

81 deputetë kanë marrë pjesë në votim. 81 janë për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-157 për ratifikimin e marrëveshjes së financimit për sigurinë e ujit dhe kanalit të Ibër-Lepencit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Në orën 14:45, këtu!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Ju lutem, fillojmë me shqyrtimet e ligjeve në lexim të parë.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbështetje të vendimit të seancës plenare nr. 05-5-438 të datës 30.03.2017 e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Procedimi i mëtejshëm vazhdon. E ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Hykmete Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar kryesues i seancës,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si sponsorizuese e këtij projektligji, shkurtimisht të paraqes arsyet dhe rëndësinë e rregullimit të fushës së këtij projektligji, i cili është për shoqëri tregtare.

Një nga arsyet më kryesore për hartimin e Projektligjit për shoqëri tregtare është adresimi për përafrimin e legjislacionit ekzistues me legjislacionin e BE-së, gjë e cila ka dalë si kërkesë edhe nga Marrëveshja e stabilizim asocimit, po gjithashtu është edhe pjesë e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së stabilizim asocimit.

Në fakt, një arsye tjetër, tepër e rëndësishme që të kemi një ligj të ri, është edhe çështja e mbrojtjes së investitorëve të vegjël, e cila ka qenë një çështje e ngritur për vite me radhë nga raporti i Bankës Botërore për të bërë biznes në Kosovë, që ka paraparë dhe në fakt, e ka dëshmuar në metoda të ndryshme, që legjislacioni ekzistues nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme për investitorët e vegjël.

Po ashtu, në këtë projektligj është krijuar edhe baza ligjore për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të raportimit të performancës së regjistrimit të shoqërive tregtare nëpërmjet hartimit të raporteve të rregullta, të cilat paraqesin një pasqyrë të shërbimit, të regjistrimit të shoqërive tregtare duke përfshirë të dhënat, që u nevojiten si kohë për regjistrim të një shoqërie tregtare, numri shoqërive tregtare të regjistruara dhe të çregjistruara, si dhe shoqëri tregtare të regjistruara në bazë të gjinisë.

Si dispozita të tjera ligjore në këtë projektligj me rëndësi të madhe, gjithashtu janë ato të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në Kosovë, janë edhe dispozitat që e përcaktojnë krijimin e një numri unik identifikues për shoqëritë tregtare.

Të nderuar deputetë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht Agjencia për regjistrim të bizneseve pranë kësaj ministrie, me një marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Financave tashmë ka filluar regjistrimin me numër unik të biznesit. Deri më tani brenda këtij muaji janë regjistruar rreth 950 ndërmarrje me numër unik. Numri unik është një numër i vetëm, të cilin ato e marrin nga Agjencia e regjistrimit të bizneseve dhe ai numër u shërben pranë të gjitha institucioneve të nivelit lokal dhe qendror, duke përfshirë këtu Administratën Tatimore dhe Doganat e Kosovës.

Tani, në këtë e kemi bërë edhe dispozitë ligjore, në mënyrë që kjo të jetë e obligueshme dhe për qeveritë që vijnë më pastaj.

Projektligji për shoqëritë tregtare, e thash edhe më herët, është paraparë në planin kombëtar. Ne kemi pasur edhe diskutimet publike dhe kemi hartuar ligje në përputhje me të gjitha procedurat e parapara sipas Rregullores për punën e Qeverisë, kemi marrë opinionin nga Ministria e Financave dhe gjithashtu opinionin e pajtueshmërisë nga Ministria e Integritetit Evropian.

Në fakt, është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili do të ndikonte drejtpërdrejtë në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në Kosovë, në simplifikimin e procedurave për regjistrim të bizneseve, po edhe mbajtjen e evidencës rreth tyre.

Unë ju lus, që ju në këtë seancë ta shqyrtoni dhe ta votoni këtë projektligj dhe natyrisht, mirëpresim të gjitha komentet dhe sugjerimet e juaja, në mënyrë që ligji me amendamente të pasurohet dhe të avancohet edhe më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Muhamet Mustafa, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kam kënaqësinë që t'i informoj deputetët, se komisioni ka zhvilluar një debat përmbajtësor lidhur me këtë projektligj dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë në parim.

Gjatë debatit komisioni konkludoi, se teksti i këtij projektligji është i rëndësishëm, pasi legjislacionin tonë organik komercial e harmonizon me legjislacionin përkatës të Bashkësisë Evropiane, si dhe me obligimet që ka marrë Kosova me Marrëveshjen e stabilizimit dhe asociimit.

Ky ligj, ose thënë më mirë, projektligj, i kontribuon përmirësimit të mëtejshëm të mjedisit për biznes dhe investime, pasi që thjeshtëson edhe më tutje procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe inkuadron regjistrimin elektronik dhe siguron me dispozitat e veta mbrojtjen më të mirë të aksionarëve të vegjël.

Në komision u theksua gjithashtu, se është me rëndësi se ky projektligj për herë të parë ndoshta, në mënyrë më adekuate, promovon disa parime të qeverisjes moderne korporatave edhe të shoqëritë tregtare në përgjithësi, duke përfshirë edhe ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha private.

Gjatë diskutimeve në komision u theksua nevoja që të plotësohen sipas nevojës disa përkufizime dhe të rishqyrtohen ndërmjet dy leximeve, në mënyrë që përkufizimet të jenë më konsistente, si për shembull anëtarët e familjes, ose familja çka nënkupton, por gjithashtu u theksua se duhet të sigurohet me dispozita që të pamundësohet, të bëhet regjistrimi fiktiv i bizneseve, për arsye se është me rëndësi që procedurat të lejohen nga të gjitha premiset burokratike dhe vonesat burokratike, por gjithashtu edhe të pengohet regjistrimi i bizneseve nga pronarë fiktivë apo të tjerë, sepse ata mund të rrezikojnë konkurrencën fer.

Komisioni konkludoi që duke e përkrahur këtë projektligj, të zhvillojë një aktivitet të gjerë me ekspertë e palë të interesit mes dy leximeve, në mënyrë që ky ligj të aprovohet brenda afateve të caktuara.

Bashkë me raportin e komisionit ju sot keni marrë edhe një propozim-vendim të Kuvendit që afatet të jenë pak të modifikuara, në mënyrë që pas shqyrtimit të sotëm amendamentet për këtë ligj të prezantohen deri më 10 prill 2017 dhe Komisioni Funkcional e komisionet e tjera të kryejnë punën deri më 25 prill 2017 dhe shqyrtimi i dytë i këtij projektligji për shoqëritë tregtare të bëhet në seancën plenare jo më vonë se më 11-12 maj 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Partinë Demokratike, Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje ministre,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Që në fillim dua të shpreh se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet Ligjin për shoqëri tregtare.

Ne si përfaqësues të Grupit Parlamentar të PDK-së e kemi shqyrtuar edhe në komision këtë projektligj, i kemi dhënë mbështetje.

Vërejtjet e sugjerimet tona, të cilat i kemi identifikuar gjatë asaj faze, do t'i japim në fazën e amendamentimit në mes të dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, Blerim Grainca e ka fjalën.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah në parim Ligjin për shoqëritë tregtare dhe konsiderojmë se me këtë ligj bëhet një përafrim i legjislacionit me legjislacionin e BE-së, e po ashtu edhe harmonizohet me obligimet që dalin nga MSA-ja.

Përveç këtyre dy gjërave, ky ligj ofron edhe disa gjëra apo ka edhe beneficione të tjera, siç janë eliminimi i disa procedurave burokratike rreth regjistrimit, pastaj futja e regjistrimit elektronik të bizneseve që u mundëson bizneseve të bëjnë regjistrime edhe elektronike, dhe po ashtu u mundëson një mbrojtje të veçantë kompanive të vogla, gjegjësisht ndërmarrjeve të vogla.

Në këtë kontekst, ne rekomandojmë që ky ligj, i bashkuar me rekomandimet e komisionit, të votohet sot dhe deputetët e LDK-së në mes dy leximeve do të japin kontributin e tyre në vazhdim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim dhe kontributi ynë do të jepet mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në parim unë e përkrah ligjin, por sigurisht se ne do të japim kontributin tonë edhe në mes të dy leximeve.

E kam një vërejtje dhe do t'ju adresoj juve si Kryesi, ekziston një rend i ditës këtu, të cilin u morëm vesh të fusim në rend dite, por jo para pikave të tjera.

Dhe, e dyta, ka këtu pika, të cilat është dashur të votohen në fillim të seancës, dhe ju si Kryesi është dashur ta menaxhoni më mirë, sepse tash nuk ke votues as për këtë ligj të kalohet në lexim të parë, sepse po shihen sa janë këtu dhe ne vetëm mund t'i debatojmë shpejt e shpejt, por nesër në seancën e re, para se të fillojmë me pyetje parlamentare dhe ato jashtë rendit të ditës, të futen këto pika, e pastaj të kalojmë në seancë të re.

Në të kundërtën, praktika po tregon që edhe Parlamenti ka filluar të lodhet, njëjtë si Qeveria dhe nuk po reflekton në nivel të asaj që sigurisht duhet të rikonfigurohet skena politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë s'është herë e parë, me Rregullore të Kuvendit ligjet mund të diskutohen, por nuk mund të votohen pa qenë të pranishëm 61 deputetë, dhe kjo dihet.

Seanca, pra, mund të punojë sipas Rregullores.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Komisioni Funkcional për Shëndetësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

Ministri i Mirëqenies Sociale nuk është këtu, por ministrja e angazhuar për këtë do ta paraqesë projektligjin. Urdhëro, zonja ministre!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale sot para jush paraqes Projektligjin për ndërmarrjet sociale.

Objektiv kryesor i këtij projektligji është që të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë sociale nëpërmjet krijimit të ndërmarrjeve sociale, të cilat i adresojnë çështjet sociale, duke përfshirë punësimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe të mirave me interes të shoqërisë.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të krijohen vende të reja të punës, me theks të veçantë për grupet e cenuara dhe ofrimin e shërbimeve sociale të personave në nevojë.

Ky projektligj përmban rregullat që i përkufizojnë parimet e ndërmarrjeve sociale, aktivitetet dhe kushtet e punës së tyre, marrjen dhe humbjen e statusit të ndërmarrjeve sociale, organizimin, funksionimin dhe rregullat e kontrollit, si dhe ato të mbikëqyrjes së ndërmarrjeve sociale.

Sipas këtij projektligji, ndërmarrjet sociale përfshijnë dy forma: integrimin në punë të personave të cenuar dhe ofrimin e shërbimeve sociale të personat në nevojë.

Këto forma do të jenë të përcaktuara në projektligj, dhe janë si: Kategori A dhe Kategoria B.

Në Kategorinë A janë të kategorizuara ndërmarrjet sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale për grupe të cenuara, ku janë të përcaktuara edhe cilat lloje të shërbimeve sociale mund të ofrohen.

Në Kategorinë B janë të kategorizuara ndërmarrjet sociale, të cilat punësojnë së paku 30% të grupeve të cenuara.

Grupe të cenuara, sipas këtij projektligji janë listuar personat, të cilët kanë vështirësi për t'u integruar në tregun e punës për arsye të ndryshme.

Ndërmarrjet sociale mund të jenë persona juridikë, të cilët kanë mundësi të gjenerimit të fitimit, por jo edhe të shpërndarjes në mes të anëtarëve apo themeluesve.

Fitimet e gjeneruara nga aktivitetet e tyre gjithmonë do të rinvestohen për vazhdimin e aktiviteteve të projektit dhe rritjen e punësimit në këto ndërmarrje.

Ndaj tyre do të zbatohen rregullat e transparencës dhe të kontrollit, në mënyrë që ndërmarrja sociale të mos mund të devijojë nga qëllimi social për të cilin edhe themelohet.

Besoj se detaje të tjera i keni në projektligj, i cili mendoj se është ligj i rëndësishëm, për çka biseduam edhe me deputeten Brovina që e kanë shqyrtuar edhe në komision.

Ministria thotë se i ka përcjellë të gjitha procedurat, Deklaratën financiare dhe përafrimin me “acquis communautaire” nga Ministria e Integritimit Evropian.

Andaj duke qenë se është edhe kërkesë e BE-së dhe ligj shumë i rëndësishëm, ju lus prapë që ta shqyrtoni dhe ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! E ftoj deputetin Nehat Baftiu që në emër të Komisionit Funkcional të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Atëherë fjalën ia japim zonjës Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit! Flas në emër të komisionit dhe Grupit Parlamentar.

Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë ligj dhe rekomandon që ky ligj të votohet.

Papunësia dhe përfaqësimi social, mungesa e afrimit të shërbimeve të ndryshme në favor të shoqërisë është një sfidë e shoqërisë sonë, por është edhe sfidë për shoqërinë në zhvillim, dhe në shoqëritë që kanë punësim të mjaftueshëm, ose me një fjalë, kanë papunësi të ulët.

Në Kosovë gjithnjë kjo çështje është lidhur me përfshirjen sociale dhe aftësimin e shërbimeve sociale, kryesisht në organizatat joqeveritare, duke qenë se ato edhe i kanë ofruar shërbimet e tilla.

Shembulli më i mirë i aftësisë profesionale të gruas të abuzuar gjatë luftës, ose të atyre që vuajnë me sindromin post-traumatik, personave që kanë probleme të tjera ose ndihen të marginalizuar.

Do të përmend vetëm disa nga këto organizata, të cilat edhe tani, si gratë e veja e të tjera që u kanë ofruar këtë ndihmë.

Për shembull, gratë e Krushës, gratë në kuadër të Qendrës për Rehabilitimin e nënës dhe fëmijës, Karitasi, Gratë për Gratë, e të tjera, në qendër të të cilave u aftësuan një numër i konsiderueshëm i grave për prodhimin e pemëve e perimeve, konservimin e tyre, aftësinë për punë të tjera, sikur që është rrobaqepësia, floktaria, përgatitjen e ushqimeve, përkujdesjen e fëmijëve dhe shërbime të tjera që janë të nevojshme për shoqërinë.

Është mirë që këtij ligji i paraprin Ligi për punë vullnetare, i aprovuar në këtë Kuvend para disa kohëve dhe këto dy ligje janë në sinkroni, sepse përfaqësojnë të njëjtin interes, të të njëjtit grup.

Pra, sikur që thashë, komisioni rekomandon që ky ligj të shkojë më tutje.

Ligji, megjithatë ka nevojë për amendamentim dhe plotësim-ndryshim, sepse ndërmarrjet sociale, si të tilla, nuk janë një ide e re në shoqërinë tonë.

Edhe në mandatin e kaluar Komisioni Evropian pati sjellë një program në Ministrinë e Çështjeve Sociale, me të cilin pretendohet që të themeloheshin inkubatorët për përgatitjen e atyre që do të punojnë në ndërmarrje sociale dhe konstatoj që pikërisht kjo - pra inkubatorët në këtë ligj, mungojnë, prandaj së pari lidhur me këtë duhet të jetë një amendament, sepse pa këtë amendament ky ligj është i mangët.

Besoj se komisioni do të punojë seriozisht dhe do t'i përdorë edhe praktikatat e shteteve, të cilat kanë përvojë dhe natyrisht të plotësohet me të gjitha vërejtjet, të cilat do t'i hasim në terren dhe do të bëhet sa më funksional, në favor të kategorive më të ndjeshme të shoqërisë, sikur që u përmendën edhe nga ana e ministres.

Pra, propozoj që të votohet ky projektligj në këtë seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina! Salih Morina, për Grupin Parlamentar të LDK-së e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve, andaj i ftoj deputetët që ta votojnë në parim Projektligjin për ndërmarrjet sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faton Topalli e ka fjalën, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në qoftë se në Evropë ka ndonjë vend ku ka shumë qytetarë të marginalizuar, të rrezikuar, duke filluar prej personave pa përkujdesje, qytetarë me nevoja të veçanta, fëmijë pa prind, të lënduar nga minat gjatë luftës, gra të dhunuara, persona të shtyrë në moshë dhe pa përkujdesje familjare, pjesëtarë të minoritetit rom, ashkali e egjiptian dhe minoritete të tjera, atëherë ky vend është Republika e Kosovës.

Ligji që e kemi para veti është shumë i nevojshëm dhe vjen me një vonesë prej 17 vjetësh. Kjo, pak a shumë tregon qasjen që patën qeveritë e deritanishme lidhur me pjesët e marginalizuara të shoqërisë sonë. Me fjalë të tjera, zero interes.

Edhe zhurma, e cila momentalisht është duke u bërë në Kuvend, po tregon se deputetët janë jashtëzakonisht të paimterësuar për të debatuar për këtë ligj.

Ky ligj, besoj i përkthyer dhe i kopjuar nga praktikat sociale evropiane, që ka të bëjë edhe me liritë themelore të njeriut, përmban vetëm konturat e idesë, por nuk ofron mundësi për një implementim praktik për qëllimin që është bërë.

Kjo lë përshtypjen se Qeveria ka sjellë këtë ligj më shumë për dekor, më shumë për të përfituar nga pjesët e marginalizuara të shoqërisë, pra në kurriz të tyre, se sa për t'i mbështetur vërtet ato.

Unë dua të ndalem në njërin prej aspekteve kryesore të këtij ligji.

Që të kemi një rregullim, është vetëm çështje e përcaktimit formal. Përmbajtjesor është aspekti se si do të bëhet ky rregullim.

Sipas nenit 5 të tij, pika 1.1 ndërmarrjet sociale angazhohen në ofrimin e shërbimeve që garanton përfshirjen e personave të marginalizuar dhe prodhon ndikim pozitiv në cilësinë e jetës së tyre, që janë potencialisht në rrezik të përjetshëm, të përjashtimit social.

Pra, fjala është për qytetarë që kanë probleme të ndryshme dhe pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të problemeve kërkohet një trajtim profesional dhe i veçantë.

Nuk mund të krijosh një ndërmarrje sociale, të ofrosh shërbime sociale, qoftë për të rregulluar kualitetin e jetës së tyre, qoftë për t'i integruar në shoqëri pa një qasje profesionale dhe pa një staf profesional.

Të trajtosh fëmijët me nevoja të veçanta nevojiten njohuri specifike, punonjës me arsim të specializuar në këtë fushë, sikur që janë punëtorë socialë, pedagogë, psikologë, mjekë, e të tjerë.

Ndryshe, trajtimi joprofesional mund të sjellë më shumë dëm sesa dobi.

Përveç kësaj ndërmarrjet sociale që ofrojnë shërbime të tilla duhet të kenë koncepte për shërbimet që i ofrojnë, t'i arsyetojnë ato në kuptimin teorik, të përcaktohen për metodologjinë e punës që do ta zhvillojnë, të kenë të përcaktuara qëllimet e punës që bëjnë, që puna e tyre të jetë transparente, e arsyetuar dhe në fund me indikatorë të matshëm për suksesin dhe cilësinë e shërbimeve.

Mjerisht, askund dhe në asnjë nen të këtij projektligji çështja e profesionalitetit të këtyre ndërmarrjeve nuk është përmendur.

Kjo rrezikon që, sipas këtij ligji, të krijohen ndërmarrje sociale, por të ofrohen shërbime jocijënsore nga organizata pa koncepte profesionale, pa staf profesional dhe pa efekte të matshme për punën që e bëjnë.

Nëse ligji nuk e përcakton si kriter edhe profesionalizmin për ndërmarrjet sociale, nëse nuk i përcakton paraprakisht kërkesat që ndërmarrjet sociale të kenë koncepte profesionale për punën dhe shërbimet që i ofrojnë, dhe nëse ky ligj nuk ka kriterë që shërbimet që bëhen në ndërmarrjet sociale të bëhen nga profesionistë të fushës, atëherë ky ligj, i përgatitur për pjesët e margjinalizuara të shoqërisë, sjell rrezikun e madh t'i kontribuojë punësimit të personave të pamargjinalizuar në kurriz të atyre që kanë nevojë dhe mund të përfitojnë nga ky ligj.

Nëse është qëllimi të krijohen ndërmarrje sociale vetëm sa për t'i pasur si dekor, nëse ky projektligj ka për qëllim pjesë të caktuara të buxhetit t'u japim njerëzve të afërt me pushtetin, nëse nëpërmjet këtij ligji synojmë t'i punësojmë militantët partiakë, atëherë ky projektligj është perfekt, sepse përveç se përcakton kategoritë e shërbimeve, emërimit e nocioneve dhe ka një emër të bukur, nuk përmbush kriteret kryesore që shërbimet dhe punësimi për pjesët e margjinalizuara të shoqërisë të garantohet.

Ne kemi jashtëzakonisht shumë nevojë për një ligj për ndërmarrjet sociale. Unë vërtet ndihem mirë që Qeveria e Kosovës po shërbehet nga programi dhe përcaktimi social i Lëvizjes "Vetëvendosje".

Por nëse kopjoni, atëherë kopjoni mirë dhe mos i merrni idetë për t'i kthyer pastaj në të kundërtën e tyre.

Ne, si Lëvizje “Vetëvendosje” do të angazhohemi që ky projektligj, që ka pjesën e konturave dhe të dekorit, ta ketë edhe përmbajtjen që duhet ta ketë për të përfituar vërtet ata që kanë nevojë të përfitojnë nga këto ndërmarrje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Duke ditur rëndësinë e këtij ligji, ne si Grup Parlamentar e përkrahim në parim, edhe pse jemi të vetëdijshëm se ka mangësi të shumta, por kohën të cilën e kanë në dispozicion deputetët në komisionet funksionale dhe angazhimi i sinqertë i tyre do të bëjë që ligji të jetë i zbatueshëm dhe të jetë në interes të ndërmarrjeve sociale.

Andaj, duke besuar në punën e anëtarëve të komisionit, ne si Grup Parlamentar do të angazhohemi dhe do të punojmë për të bërë një ligj të zbatueshëm dhe në interes të shoqërive dhe ndërmarrjeve sociale, por edhe të qytetarëve në përgjithësi.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Njomza Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

E nderuar ministre,

Faleminderit për prezantimin!

Njëherësh më lejoni të shpreh konsideratën time për Qeverinë e Republikës së Kosovës, këtë herë për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, për projektligjin që jemi duke e diskutuar për ndërmarrjet sociale dhe konsideroj se ka qenë shumë i nevojshëm dhe tani është momenti që edhe këto ndryshime apo këto propozime që do të vijnë nga përfaqësuesit tanë që janë në Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale të kenë parasysh në fazën e implementimit.

Ndërmarrjet sociale, mendoj kanë shumë hapësirë, siç e tha edhe kolegu Topalli, sa i përket profesioneve që duhet t’i kenë, duhet të jenë të profilizuara, duke filluar nga puna sociale, punonjësit socialë.

Ne e dimë që i kemi qendrat për punë sociale, mirëpo departament nuk kemi sa i përket punës sociale.

Tani ka filluar gjenerata e parë, mirëpo këtu ka nevojë edhe më shumë të ketë kuadro të tjera, duke filluar edhe nga fushat e tjera, si psikologë, sociologë apo edhe punonjës socialë.

Ne po i shohim çdo ditë, duke filluar edhe nga shkelja e të drejtave të fëmijëve, nga shkelja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, nga shkelja e të drejtave të grave dhe vajzave që po ballafaqohen me forma të ndryshme të dhunës ndaj tyre.

Dhe, unë mendoj se këto ndërmarrje sociale do të duhej të vepronin në kuadër të shërbimeve profesionale, kur të fillojë të implementohet dhe të jenë në zbatim të projektligjit.

Prandaj, edhe një herë dua të shpreh po ashtu konsideratën për këtë projektligj dhe po shpresoj që gjatë implementimit të kihen parasysh edhe këto kuadro profesionale për të qenë të përfshira në ndërmarrje sociale dhe jo vetëm sa për të gjetur një punë të personave që aplikojnë në ato ndërmarrje sociale. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Deputetja Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Pa dashur t'i përsëris ato që tashmë kolegët i thanë dhe, në veçanti kolegu nga subjekti im parlamentar, besoj se iniciativa është e mirë dhe megjithatë, projektligji si i tillë ka nevojë për ndryshime e plotësime, në mënyrë që të ketë vërtet edhe kuptimin e emrit çfarë e ka.

Disa nga propozimet që unë do t'i jap tani shpresoj se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale do t'i ketë parasysh gjatë amendamentimit dhe plotësimit të tij.

Konkretisht, pika 4 e nenit 5 përcakton fushat në të cilat ndërmarrjet sociale mund të zhvillojnë veprimtarinë e tyre, si për shembull: "Kultivimi dhe rritja e erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore, konservimi i frutave dhe perimeve nga ekonomitë familjare që i prodhojnë apo i kultivojnë këto produkte në zonat rurale apo urbane".

Pra, fjala është këtu për ndërmarrjet sociale të Kategorisë B.

Për mua është plotësisht e paqartë pse Qeveria me këtë projektligj i përcakton strikt se cilat janë fushat në të cilat duhet të veprojnë ndërmarrjet sociale të Kategorisë B.

Në memorandumun shpjegues, një përcaktim i tillë nuk është i arsyetuar.

Duke pasur parasysh se ligji synon integrimin e pjesëve të marginalizuara apo njerëzve të marginalizuar të shoqërisë, pyetja është: pse Qeveria me këtë projektligj kundër marginalizimit, në fakt, po e bën vet një marginalizim të tillë duke i ngushtuar fushat e ekonomisë ku ato mund të veprojnë?

Pra, me një ligj kundër marginalizimit, Qeveria po i marginalizon ato.

Unë besoj se në shoqërinë tonë kemi mjaft profesionistë që kanë ide inovative përtej ideve të Qeverisë dhe mund të krijojnë vende të punës, si në ekonomi të vogla e të mesme, që i shërbejnë idesë së punësimit. Prandaj, me ligj duhet t'u ofrohet një mundësi e tillë.

Përcaktimi i fushave të veprimtarisë së ndërmarrjeve të Kategorisë B ngushton mundësinë e punësimit dhe integritit në shoqëri, madje e kthen ligjin në të kundërtën e asaj për të cilin e ka qëllimin.

Për mua është gjithashtu shumë problematik neni 5, pika 4.4 lidhur me veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale të Kategorisë B.

Neni 5, pika 4.4 thotë që në mes fushave të tjera, për të cilat mund të veprojnë ndërmarrjet sociale, është edhe prodhimi dhe përgatitja si e produkteve të bëra me dorë, ashtu edhe me makinë për shtëpi, dekorim publik apo joqeveritar.

Pyetja dhe kritika ime për Qeverinë është: pse Qeveria e përjashton përgatitjen apo ofrimin e shërbimeve të destinuara për vetë Qeverinë?

Do të duhej të ishte e kundërta. Qeveria, nëse vërtet dëshiron të kontribuojë për pjesët e marginalizuara të shoqërisë, do të duhej të stimulonte prodhimin e tillë, duke e favorizuar atë për nevojat e Qeverisë, administratës, nevojave të komunave, institucioneve publike, e tjera.

Pra, jo t'i përjashtojë shërbimet dhe prodhimet, por t'i stimulojë duke i blerë vetë ato. Vetëm kështu mund të jepet një ndihmë dhe aktiviteti i tyre të sigurojë një lloj qëndrueshmërie.

Në fund, edhe një herë, Ligji për ndërmarrjet sociale duhet t'i heqë kufizimet e fushave të veprimit ekonomik dhe të përcaktohet gjithashtu me ligj se Qeveria, institucionet publike, komunat do t'i blejnë produktet dhe shërbimet që i ofrojnë këto ndërmarrje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-138 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz

Komisioni FunkSIONAL e ka hartuar Projektligjin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe Kuvendit i ka rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Për Komisionin FunkSIONAL që është edhe hartues i ligjit, kush e do fjalën?
Apo, kush e zëvendëson deputeten Duda Balje?

Fjalën e ka Shaipi, nëse je anëtar i komisionit? Atëherë, fjalën e ka Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Zoti nënkryetar, të falënderoj!

Dhe, prapë do t'i forcoj konkluzionet e lodhjes që po ia adresoj këtij Kuvendi dhe koordinimeve, sepse kjo ka qenë dashur të vijë nga sekretaria e partisë dhe e komisionit se kush flet për këto komisione, e jo të bëhet ky farë cirku dhe të vonohet ky ligj, sepse është dashur të kalojë shumë vjet më parë.

Unë, para se të filloj, do të falënderoj angazhimin... Kam qenë edhe udhëheqës i Nënkomisionit për ta përpiluar këtë ligj dhe për ta harmonizuar me të gjithë anëtarët, prandaj edhe i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit dhe në veçanti falënderoj Agjencinë e Menaxhimit të Komplekseve Memorialë të Kosovës që udhëhiqet nga zoti Blakaj dhe Odën e Avokatëve të Kosovës, e cila me grupet e tyre profesionale janë angazhuar që të nxjerrim një ligj, me pak nene, por me domethënie të madhe dhe të rëndësishme.

Shpallja e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" si zonë me interes të veçantë kombëtar, duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e veçantë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kontributin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes së tij për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, rolin për historinë e re të Kosovës, të cilën e ka kjo luftë dhe vendi me të cilin është zhvilluar ajo, si dhe nevojën për mbamendjen historike të popullit të Kosovës, për rëndësinë e kësaj ngjarjeje si një rast unik i heroizmit dhe sakrificës për lirinë e popullit të Kosovës, Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në shatin Prekaz, komuna e Skenderajt, shpallet zonë me interes të veçantë kombëtar për Kosovën.

Prandaj, ky ligj bazohet po ashtu edhe si kompleks memorial dhe zona të tij të përcaktuara sipas të këtij ligji dhe Ligjit për trashëgiminë kulturore do të ketë status të mbrojtjes së përhershme, që do të thotë se Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në të ardhmen, kur të bëhet anëtare e UNESCO-s Republika e Kosovës, do të jetë i shënuar edhe në objektet e mbrojtura nga UNESCO.

Përfundimisht, ju ftoj që këtë prononcim ta kuptoni edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, është një qëndrim unanim që ky ligj të kalojë sa më shpejt, përkundër moskontributit ka dhënë edhe moskomentimet fare nga Qeveria. Unë shpresoj që në leximin e dytë të kalojë sa më shpejt, siç po kërkohet për ligjet e tjera, sepse objektet në zonën memoriale momentalisht janë duke u degraduar për shkak të ekspozimit të pambrojtur nga kushtet atmosferike që janë duke dominuar.

Prandaj, është përgjegjësi kombëtare e të gjitha partive politike të angazhohemi sa më shpejt, të gjejmë mjete financiare që t'i shpëtojmë pjesët historike dhe në vazhdimësi, sipas ligjit në fuqi,

të ndahen mjetet sipas viteve për ta mbrojtur, mirëmbajtur, menaxhuar dhe financuar këtë kompleks. Faleminderit!

KRYESUESI: Më së pari të mos krijojmë konfuzion. Shaipi e tha mendimin e vet edhe si deputet, edhe në emër të Partisë Demokratike të Kosovës dhe le t'i thërrasë kolegët e vet e sa rrinë këtu, le të vijjnë ta votojnë këtë ligj.

Nënkryetari i komisionit, sipas shënimeve të mia, është Salih Salihu. Të lutem, Salih, merre fjalën. Jo, nuk ka replikë!

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14. 3. 2017 e shqyrtoi në parim Projektligjin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim që të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-138 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Po e shfrytëzoj rastin që ta paraqes edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Me që bëhet fjalë për një vend apo për një lagje, ku ka nisur rezistenca e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra lagje ku u vunë themelet e pavarësisë së Kosovës, mendojmë se është me interes të veçantë që ky kompleks të mbrohet me ligji, të rregullohet dhe të shndërrohet në një vend, në të cilin do të ketë vizitorë më së shumti, si nga qytetarët e Kosovës, ashtu edhe nga të huajt, në mënyrë që të njihen të gjithë të rinjtë tanë, ta njohin këtë regjion, këtë vend dhe të shohin se çfarë rezistence është bërë në familjen Jasharaj, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari.

Pra, ne si Lëvizje “Vetëvendosje” e mbështesim në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka fjalën, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TEUTA HAXHIU: Gjithashtu edhe ne si grup parlamentar e mbështesim shqyrtimin e partë të Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe urojmë që deputetët të punojnë vërtet arsyeshëm, në interes të bërjes së ligjeve jo shkel e shko, por me qëllimin më të mirë që t'i bëjnë të zbatueshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Unë nuk e di kush i ka bërë krejt këto ligje, por ata që vërtet e donë Kosovën, ata që vërtet e dinë mirë e mirë historinë e Kosovës, ata që e dinë kontributin e të gjithëve që e kanë dhënë për Kosovën dhe që kanë projektuar pavarësinë e Kosovës, i kanë vënë bazamentin shtetit të pavarur të Kosovës, do të duhej që sot ta kishim përpara ligjin për dy memorialë: memorialin për presidentin Rugova dhe memorialin për Adem Jasharin. Edhe unë mund ta votoj veç në këtë mënyrë, e thërras edhe LDK-në dhe të gjithë deputetët ta bëjnë këtë, jo veç LDK-ja. Nëse vërtet e duam këtë vend pa hile, nëse po duam të bëjmë fushatë, e dikush edhe po bën fushatë, fatkeqësisht mua më vjen keq, por nuk është mirë të bëhet fushatë me jo figura, po me personalitete të denja të popullit dhe shtetit të Kosovës.

Edhe një përgjigje, jo përgjigje, nuk e di le ta marrë Shaip Muja qysh të dojë, po thotë që Kuvendi i Kosovës sot, sot jo, po duhet të shkojë se nuk po punon. Qysh nuk ka punuar Qeveria? Qysh nuk po punon Qeveria? Unë e kam veç një pyetje: ku është kryetari i Kuvendit? Është mirë të pyetet edhe çka po bën? Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëro, Shaip, replikë një minutë. Shaip Muja, regjia e ka punën e vet.

SHAIP MUJA: Faleminderit! Zoti kryetar, unë më së paku kam pritur që dikush do të thotë këtu që ky ligj po bëhet për ndonjë fushatë ose për diçka, por nëse tërhiqet një paralele me Komplexin Memorial “Adem Jashari” që është unik në botë, jo me udhëheqësit e Republikës së Kosovës ose të historisë së Kosovës, por është unik në botë, ajo është një interes për të mos kaluar ky ligj.

Unë nuk desha as të politizoj më shumë, ky ligj ka qëndruar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, s’është kthyer asnjë fjali komentuese as nga plani financiar, as asgjë.

Ne e kemi tërhequr brenda rregullave që ekzistojnë si ligj dhe nuk desha të bëj politikë.

Prandaj, nuk ka nevojë këtu të politizojmë, ne nëse duam të bëjmë hajgare e të bëjmë komplekse ditë për ditë, ky është vetëm një kompleks që e njeh krejt bota, edhe ky kompleks duhet të bëhet sikur muri në Izrael, ku njerëzit betohen për lirinë edhe mbrojtjen e vendit, e që shprehin dëshira për fatin e tyre. Ai mur ashtu duhet të jetë në Prekaz, po jo të bëhet hajgare e të thuhet se po bëjmë komplekse. Ka pasur edhe ide të tilla, por janë të papranueshme, sepse as nuk kemi fuqi, as nuk kemi mundësi financiare. Ne po flasim për të shpëtuar të vetmen vlerë sublime më të lartë të kombit, i cili nuk ka vdekur për një grup. Adem Jashari nuk ka vdekur për një grup politik ose të interesit të vogël, ka vdekur për krejt Kosovës, me gjithë familjen e tij është sakrifikuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Një minutë e ka Melihate Tërmkolli. Urdhëro!

MELIHATE TËRMKOLLI: Më pak se një minutë, zoti nënkryetar.

Vlerësimin kush është unik e kush nuk është unik, nuk e bën këtu asnjë deputet, në veçanti kjo është e turpshme të bëjë dikush vlerësim kush është Adem Jashari dhe kush është Ibrahim Rugova? Është shumë e turpshme, edhe kjo është e papranueshme.

Ndërsa, se kush e njeh krejt botën, unë nuk e di a ka njeri, madje edhe në botë, jo vetëm në Kosovë që nuk e di, se krejt bota e njeh edhe Ibrahim Rugovën, para të gjithë të tjerëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Haxhi Shala, për grupin “Nisma”.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Ne si grup parlamentar do ta mbështesim në parim këtë ligj, edhe pse e kemi dhënë kontributin tonë në Komisionin për Bujqësi, kam qenë edhe vetë anëtar i këtij komisioni.

Vetëm më çudit fakti pse Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka gjetur kohë që ta trajtojë këtë ligj dhe të japë një koment për këtë ligj. Këtu shihet se sa ka qenë i interesuar ky koalicion që t’i mbrojnë vlerat e veta. Edhe sot po shihet edhe debati brenda dy partive të mëdha se si diskutojnë, debatojnë për një ligj, i cili për mua është ligji më i shenjtë që ka ardhur deri më tash sa jam në këtë mandat.

Ne do ta mbështesim këtë ligj, do të kontribuojmë prapë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë nuk kemi fije dyshimi që objekti për të cilin flet ligji dhe të cilën e trajton e ka rëndësinë e tij të shumëfishtë. Edhe është ngjarja që në historinë e re të Kosovës përbën kulmimin e sakrificës së shqiptarëve në luftën e tyre për liri, e cila ngjarje duhet të kujtohet gjithmonë, jo vetëm me akademi e aktivitete të llojeve të ngjashme, por sa më shumë, edhe me memorialë, me emra rrugësh që të përjetësohet, në një farë mënyre, edhe në jetën tonë të përditshme kujtesa për familjen sublime, që është familja Jashari.

Por unë nuk e di kush e ka shkruar këtë ligj në kuptimin kështu profesional, edhe të ekspertizës, por këtu janë disa shprehje, të cilat nuk më duken të gjetura në kuptimin profesional, edhe në kuptimin e peshës dhe rëndësisë që e ka familja Jashari dhe kompleksi për të cilën po flasim.

Për shembull, në nenin 1, ku flitet për qëllimin, e neni i parë flet për qëllimin, thuhet kështu në pikën e dytë të nenit 1: “Kompleksi Memorial ‘Adem Jashari’ në Prekaz ka rëndësi ontologjike”, këtë nuk e ka ditur kush e ka shkruar, po ‘ontologjike’ është një kategori filozofike, shumë

specifike, e cila nuk më duket se i shkon një ligji, i cili flet për memorialët edhe për një ngjarje historike, siç është kjo e sakrificës Jashari.

Si pikë e dytë e rëndësisë përmendet rëndësia antropologjike. A e dini, edhe kjo, nuk e di kush e ka shkruar këtë ligj, po me të vërtetë lë shumë për të dëshiruar.

Unë do të thosha që vlerat të cilat duhet të renditen në këtë ligj, e para duhet të jetë fjala ‘kombëtare’. Nëse neni 1.2 po flet për rëndësinë, thotë: “Kompleksi Memorial ‘Adem Jashari’ ka rëndësi...” Çfarë rëndësie, e para është kombëtare. Domethënë si fjalë të parë ju kisha lutur të vendoset fjala “kombëtare”, pastaj fjalën “historike” dhe pastaj të tjerat. Domethënë kujtesa, mbamendja, të përshkruhet sakrifica, e kështu me radhë. Domethënë t’i atribuohen të gjitha karakteristikat e lirisë që na ka ardhur dhe të cilën e jetojmë edhe sot, fal kësaj sakrifice që është ndër më të rëndësishmet të popullit shqiptar dhe të kombit shqiptar në përgjithësi.

Pra, këtë e pata si vërejtje, sepse jam bërë tash edhe kureshtar kush i ka shkruar këto fjalë kështu, ‘rëndësia ontologjike dhe antropologjike’. Mirëpo do të ishte me rëndësi shumë që të specifikohet.

E dyta, kur kemi të bëjmë me sakrificën e familjes Jashari dhe të komandantit legjendar Adem Jashari, unë mendoj që në raste specifike bën të veprohet sikur ashtu që ka ndodhur, për shembull, me emërtimin e aeroportit, apo me ndonjë rrugë të veçantë, apo siç ka ndodhur vënia e shtatores së Adem Jasharit në Tiranë dhe pastaj vendi edhe sheshi aty specifik e marrin edhe emrin e tij.

Po mendoj që kur të bëhet fjalë për vendin e rënies së Jasharajve, për vendin ku kanë rënë ata dhe kompleksi ku ndodhet vetë, për të cilën po flet ligji, mua do të më dukej më e arsyeshme që të quhet “Adem dhe Hamëz Jashari”, pra Kompleksi Memorial jo vetëm “Adem Jashari”. Mendoj që ata ishin të pandashëm, edhe si dy burra kështu përfaqësojnë, me emrat e tyre, vetë ata dy, si dy shtylla përfaqësojnë edhe krejt sakrificën sublime të atij farefisi, fal të cilit edhe ne jetojmë lirinë sot në Kosovë.

Pra, kur është vetëm shtatorja diku e Adem Jasharit, mund të jetë vetëm emri i tij specifik, ama vendi ku kanë rënë ata të gjithë, e që janë 60 persona, aty do të ishte mirë të figuronin emrat e të dyve, pra Adem dhe Hamëz Jashari, pra që kompleksi në përgjithësi të quhej “Adem dhe Hamzë Jashari”.

Edhe e treta, nuk jam në ngjarje bash saktë se si është proceduar, qysh ka ardhur deri te ky ligj, sepse nuk i përket edhe komisionit ku unë jam, mirëpo do të kishte qenë mirë që për ligje të tilla të konsultohet edhe Familja Jashari, domethënë edhe farefisi, edhe lagjja, edhe krejt komuniteti për të cilin po bëhet ky ligj. Pra, që të merren mendimet e tyre, të merren sugjerimet e tyre, në

mënyrë që ne të prodhojmë ligje sa më të mira për këto objekte, shumë të rëndësishme të mbamendjes sonë kolektive...

KRYESUESI: Glauk, më lejo dy fjalë që të bëhemi konkretë, për të mos thënë edhe të sinqertë. Unë e pata problem që ta caktoj kush do të flasë në emër të komisionit që e ka hartuar dhe sponsorizuar ligjin. U zbulua, njeriu foli. Kështu që nëse ka nevojë, drejtoju komisionit, sepse e ka sponsorizuar komisioni. Është e vërtetë që në ligj implikohen komisione të veçanta, e Qeveria, e filan ministri, e filan resori e krejt, por meqë po bisedojmë për një projektligj dhe sponsorizues është komisioni, anëtarët e komisionit janë të detyruar ta mbrojnë dhe të japin shpjegime. Kaq! Tutje fjalën e ka Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Asnjërit prej nesh nuk i lënë shije të mirë këto replika ndërmjet vete për këso çështjesh shumë të rëndësishme. Konsideroj që nuk e kanë vendin sot pikërisht kur diskutohet edhe ky ligj i shumëpritur.

Të nderuar deputetë,

Në themelet e shtetit të Kosovës është sakrificë sublime e komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe dëshmorëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” e ka marrë legjitimitetin e vet tash e gati 20 vjet, me miliona vizitorë nga të gjitha trojet shqiptare dhe nga Diaspora, vizitorë të shumtë edhe të huaj, të cilët kanë lënë kujtimet e veta në librin memorial në këtë kompleks. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” tash e sa vite me radhë është bërë vend i shenjtë, vend i përkuljes, nderimit, vend i ndërgjegjes, burim frymëzimi dhe krenarie për të gjithë ne dhe për brezat që vijnë.

Andaj, vendosja e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” nën mbrojtje ligjore tregon përkushtimin e shtetit, pasi trajtimi me ligj të veçantë bëhet vetëm për çështje të rëndësishme të veçantë. Ky ligj garanton se kujtesa jonë historike do të dokumentohet në mënyrë të saktë që t’u shërbejë brezave që vijnë, si dhe do të shmangë çfarëdo tendence për relativizimin e kësaj lufte.

Pra, rëndësia dhe qëllimi i luftës së Adem Jasharit do të institucionalizohet dhe këtij fakti duhet t’i gëzohemi të gjithë. Sapo të fillojmë ta respektojmë vetveten dhe sakrificat tona, sigurisht që edhe të tjerët do të na respektojnë. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

ABDYL YMERI: Në librat e përshtypjeve janë të shënuara përshtypjet nga më të ndryshmet e vizitorëve, duke filluar nga personalitet të shquara shtetërore të vendit dhe ndërkombëtare, nga personalitete të teatrit, shkencës e kulturës, si dhe nga qytetarë nga e gjithë gjeografia shqiptare, gjatë vizitave të tyre në Kompleksin Memorial dhe në Familjen Jashari. Me këtë rast, unë kam

veçuar përshtypjen e delegacionit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Qëndresa heroike e Komandantit Legjendar Adem Jashari, si dhe e gjithë familjes së tij është mishërim i trimërisë dhe i dashurisë se zjarrtë për lirinë e Atdheut të të gjithë shqiptarëve të Kosovës.

Tanimë Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz është shndërruar në një vend pelegrinazhi, apo siç shprehen vizitorët në një vend të shenjtë të shqiptarëve, i cili nuk kalon asnjë ditë e vetme pa u vizituar nga qytetarë të shumtë që e bënë vendin me të vizituar në Kosovë, ku të gjithë vizitorët shprehin emocionet dhe ndjenjat e veçanta duke u përkulur para varrit të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe Familjes së tij dhe Lagjes Jasharaj në përgjithësi për luftën, qëndresën, si një rast unik i heroizmit dhe sakrificës për lirinë e popullit të Kosovës,

Prandaj, është mirë që më në fund ka ardhur projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, i cili për mendimin tim e po besoj edhe për çdo qytetar është i një rëndësie të veçantë, sepse përcaktohet statusi, si dhe obligimet e institucioneve të Kosovës për planifikimin, ndërtimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, kujdesin dhe prezantimin e tij, që është qëllimi i këtij projektligji në nenin 1.

Në bazë të nenit 3, Kompleksi Memorial “Adem Jashari” shpallet zonë me interes të veçantë kombëtar.

Plani urbanistik i Kompleksit Memorial në Prekaz ende nuk ka përfunduar.

Deri më tani është punuar vetëm në hapësirën e ngushtë të kompleksit, sepse sipas nenit 4 - hapësira e zonës së veçantë është gjithsej katërqind e pesëdhjetë hektarë (450 ha) sipas planit të aprovuar për kompleksin, e në përputhje me sipërfaqen e përcaktuar me ligjet në fuqi janë rregulluar varret në kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve të Jasharëve, janë vendosur pllakat e mermerta në gjithë pjesën e planifikuar, pastaj janë bërë zonat e gjelbëruara, është rregulluar shtrati i përroskës që kalon nëpër lagje, është bërë rruga deri te bunkerit i Adem Jasharit, është ndërtuar objekti në hyrje, i cili shërben për pranimin e vizitorëve, si dhe është ndërtuar amfiteatri në anën e djathtë me fontanën në mes. Ajo që është e ngutshme që duhet bërë në kompleks është konservimi i kullave të rezistencës dhe bunkerit.

Në nenin 5, projekti për kompleksin, paragrafi 1: Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz do të realizohet sipas projektit, i cili përzgjidhet në bazë të shpalljes së hapur dhe publike

Paragrafi 2: Përzgjedhjen e projektit do ta bëjë Këshilli i veçantë, i emëruar me vendim të Qeverisë, me kërkesën e drejtorit të Agjencisë. 3: Këshilli nga paragrafi 2 i këtij neni përbëhet

nga: përfaqësuesi i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përfaqësuesi i Komunës së Skenderajt, përfaqësuesi i Familjes Jashari, përfaqësuesi i Shoqatës së Arkitektëve dhe përfaqësuesi i OVL të UÇK-së.

Unë propozoj, në bazë të kërkesës dhe kritereve të kërkuara, që së pari të bëhet një analizë dhe ekspertizë më detaje dhe shqyrtim paraprak i projektit nga ekspertët e kësaj fushe, të cilët do t'i rekomandonin Këshillit të veçantë se cili është projekti më i mirë dhe më i duhur, i cili i përmbush kërkesat dhe kriteret sipas standardeve më të avancuara.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Murat Hoxha.

MURAT HOXHA: Faleminderit, kryesues!

Nënkryetar, më duket që pak e tejkalove LDK-në, nuk e di pse, apo gabove, sepse gabimet janë të zakonshme. Mirë, unë po flas në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Ligjin për memorialin “Adem Jashari” dhe natyrisht që qëndrimi i LDK-së është që të votohet ky ligj. Megjithatë, dua të bisedoj edhe për çështjen, të cilën e shtroi zonja Melihate Tërnkolli, e kjo çështje është ngritur, do të thotë hartimi i Ligjit për memorialin “Ibrahim Rugova” është ngritur edhe në komision dhe unë mendoj që personaliteti i Rugovës dhe komandanti legjendar Adem Jashari janë dy komponentë, dy figura komplementare mes vete, njëri është arkitekt i projektit të pavarësisë, ndërsa i dyti zbatues i komponentit të armatosur të luftës për liri.

Unë shpresoj që ky ligj do të na vijë shpejt prej Qeverisë, prandaj pres që të na vijë, sepse Ligji për memorialin “Ibrahim Rugova” këtë e plotëson, do të thotë e plotëson binomin e lirisë dhe pavarësisë. Është punuar shumë për Ligjin e memorialit “Adem Jashari”, është punuar një vjet. Komisioni e ka marrë edhe pëlqimin e familjes, kemi qenë në vizitë atje. Mendoj që sa më shpejt të plotësohet edhe me një ligj, do të thotë edhe me Ligjin për Ibrahim Rugovën, në mënyrë që të plotësohet ky binom, i cili me të vërtetë është i nevojshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Po, tjera herë paraqituni, dije që duhet prekur sustën që të regjistroheni. Unë po kërcej te njerëzit, edhe që s'përfaqësojnë parti, sepse ata po paraqiten. Shikojini listat mirë.

Atëherë, fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari dua ta përgëzoj komisionin i cili ka iniciuar këtë projektligj, një nga projektligjet që do të duhej vërtet që shumë kohë më herët të procedohej dhe dola për të folur sot për shkak se tani dy vjet jam duke bërë amendamente dhe ky Kuvend duke ndarë mjete për restaurimin e shtëpive muze në Lagjen Jasharaj. Vitin e kaluar, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nuk i ka shfrytëzuar mjetet që kanë qenë të parapara për këtë projekt, i ka çuar në suficit. I kemi përsëritur ato mjete tani me një kod buxhetor tjetër, i cili është në kuadër të Agjencisë për Komplekse Memorialë dhe më vjen mirë që tani edhe me këtë projektligj adresimi i përgjegjësive është i saktë sa u përket investimeve kapitale, sa i përket mirëmbajtjes, sepse u tha edhe nga parafolësit, sepse është një ligj i historisë, është një ligj me rëndësi të veçantë në aspektin kombëtar, historik, kulturor e tjera.

Dhe, absolutisht nuk mendoj që këtu dikush dëshiron të bëjë politikë me ligje të rëndësishme të këtyllë, por që vërtet jemi në shërbim që ta bëjmë një ligj të mirë, e para se gjithash që investimet në restaurimin e shtëpive muze në Lagjen Jasharaj të jenë emergjente, sepse shtëpitë rrezikohen nga rrënimi dhe nuk ka pasur një reagim të institucioneve përkatëse që ato të restaurohen, e në veçanti të konservohen.

Gjithashtu, ligji në nenet e vet e ka paraparë ligji edhe aspektin e shpronësimeve apo dhe zhvendosjes. Prandaj, është një ligj që në tërësi mendoj që edhe ashtu sa i përket emërimit që është Ligji për Kompleksin “Adem Jashari”, por ky ligj ka të bëjë me kompleksin Jasharaj në tërësi, me Lagjen Jasharaj, sepse Lagjia Jasharaj dhe shtëpitë-muze në Lagjen Jasharaj kanë nevojë për ruajtje, mbrojtje, konservim, e në veçanti që ato të jenë domethënëse për gjeneratat e reja, për të gjithë ata vizitorë, të cilët do të shkojnë për vizitë në Lagjen Jasharaj.

Gjurmët e historisë tonë më të re po rrezikohen të humbasin për shkak të moskonservimit dhe mosrestaurimit të shtëpive-muze. Prandaj, është më se emergjente, më se e nevojshme që kjo ndodh dhe tani adresimi i përgjegjësive të jetë ligjor, edhe në aspektin e projektimit, edhe në aspektin e investimeve kapitale, në veçanti në aspektin e mirëmbajtjes dhe të personalitete që do të udhëheqin me shpjegimin e historisë së Jasharajve për të gjithë vizitorët, me ciceronë adekuatë përgjegjës dhe profesionalë, të cilët këtë histori duhet ta mësojnë që nga fillimi e deri në fund ashtu si është.

Absolutisht nuk pajtohem se këtu dikush ka intencë që të bëjë politikë me këtë ligj dhe absolutisht nuk pajtohem se është diçka jounike rasti i Jasharajve. Është rast dhe kompleks unik në vendin tonë, është një kompleks i cili do mbrojtje emergjente, sepse unë e di se këtu po rrezikohet rrënimi i shtëpive dhe gjithsesi, kushdo që ka iniciativë tjera edhe për mbrojtjen e komplekseve tjera, patjetër që do të ketë për figura dhe personalitete të veçanta, përpara se t'i fusë në mbrojtje vilat e caktuara, qofshin ato në Velani, apo diku tjetër. Ndërsa, shtëpitë në Lagjen Jasharaj po rrezikohen të rrënohen, nuk besoj se ndonjë vilë në Prishtinë është në rrezik nga rrënimi apo shkatërrimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe një herë, pra, se sa po bëhet politikë këtu ndërmjet PDK-së dhe LDK-së kjo nuk do koment, por po jua rikujtoj të gjithë atyre deputetëve dhe qytetarëve që nuk e dinë, që ndër vendimet e para të kryeministrit të atëhershëm, zotit Ramush Haradinaj, ishte vendimi për rregullimin dhe shpalljen si zonë ekspozue me interes të veçantë të kompleksit të Familjes Jashari. Pa politikë, atëherë!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Nuk ka diskutime të tjera. S'ta ka përmendur emrin. Urdhëro Melihate, një minutë!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Unë vetëm gjysmë minute, për hir të së vërtetës dhe për hir të asaj që gjithçka këtu mbetet dhe mbetet një ditë në letër, për ta plotësuar krejt të vërtetën.

Kurrkush nuk është kundër Ligjit për memorialin “Adem Jashari”, por e vërteta dhe kujtesa historike duhet të jetë e plotë. Kujdesa historike selektive nënkupton diçka tjetër. Kujtesa historike kolektive është gënjeshtër. Ju filozofët e dini, sidomos ju, kush është filozof këtu.

Dhe, për hir të së vërtetës, këtë që e tha Teuta Haxhiu, në fakt është e vërtetë, që në Qeverinë Ramush Haradinaj është marrë vendimi i parë, por kërkesën e parë, Teutë, e ka bërë Ibrahim Rugova.

Jo, jo, më fal! Unë e di shumë mirë, se kam qenë aty dhe e di mirë. Kërkesën me shkrim e ka bërë Ibrahim Rugova, kërkesën e parë që të bëhet Memoriali i Adem Jasharit. Pikë!

KRYESUESI: Atëherë, nuk ka të tjerë. Shaip, merre fjalën. Po, emrin s'ta ka përmendur askush, po ke qejf. Një minutë e ka Shaipi.

SHAIP MUJA: Jo një minutë, por i kam dhjetë minuta. Tash po flas si deputet. Fola në emër të grupit, fola në emër të komisionit, tash po flas si deputet. Po!

Prandaj, mos më trego, Rregullorja kështu thotë. Edhe, mos m'i harxho minutat, zoti nënkryetar, të lutem! Faleminderit!

Faleminderit, zoti nënkryetar! Pak sa për relaksim, kështu...

Unë i dëgjova vërejtjet dhe ne kemi mundësi në leximin e dytë t'i plotësojmë shumë vërejtje. Me gjithë respektin, edhe nga interpretimi filozofik që e dha zoti Glauk, edhe unë mendoj që nga aspekti filozofik, antropologjia dhe ontologjia janë të qëlluara për këtë kompleks.

Unë e kam edhe definicionin çka është ontologjia, ajo merret me përdorimin e përpiktë të fjalëve si përshkruese të vetes ose realitetit dhe rrjedh nga fjala greke "ontos", që do të thotë qenie dhe "logia" - fjalë, dituri, mësim.

Ndërsa antropologjia, që ndahet në disa pjesë filozofike dhe biologjike, merret në mënyrë decisive me ruajtjen, konservimin e atyre kufomave nga aspekti fizik, i cili nuk duhet trajtuar ndryshe, por duke u konservuar. Prandaj, e ka edhe qenien e një monumenti, një kompleksi dhe kjo është e qëlluar, mendoj. Por, në leximin e dytë kemi mundësi të bisedojmë të gjithë.

Çështja tjetër, baraspesha e një kompleksi të tillë. Kosova duhet të shpallet monument, e tërë Kosova, sa ka rezistuar gjatë shekujve nga perandori të ndryshme, të cilat nuk ka nevojë këtu t'i përmendim. Por, monumenti dhe Kompleksi Memorial "Adem Jashari" është monument historik i papërsëritshëm unik në botë dhe është obligim i të gjitha grupeve, as s'ka politikë këtu, por ta mbrojmë, sepse brezat e ardhshëm kanë interes, ai kompleks është për shqiptarët, është në interes për serbët ta shohin çfarë krimesh kanë bërë. Nuk ka këtu asnjë dëmtim që i bëhet dikujt politikisht.

Prandaj, të mos e politizojmë, por edhe Qeveria të mobilizohet dhe të shihet. Sa më shpejt t'i ndajmë mjetet. T'i ruajmë ato pjesë që kanë mbetur. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, unë besoj që më nuk kemi... Teutë, e ke ndërmend të vazhdosësh? Teuta, një minutë!

TEUTA HAXHIU: Nënkryetar, ma kanë përmendur emrin.

Edhe një herë, vendim historik, e thanë edhe më parë, qysh në vendimet e para të kryeministrit Haradinaj. Me rëndësi është kush e ka nënshkruar dhe kush i ka ndarë paratë, edhe përkundër presionit nga UNMIK-ut për shkak të buxhetit të kufizuar nën administrimin e UNMIK-ut. Me rëndësi është kush e ka nënshkruar.

Edhe një herë po them, vendim historik dhe pa politikë, në kohën e duhur. Tani sot mund të bëjmë politikë, që fatkeqësisht nuk do të duhej të bëhej, po mendoj politikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë besoj që i kemi kryer të gjitha bisedat. E unë, t'jua them të drejtën, me të gjithë po pajtohem kësaj radhe. Sepse, secili po bën politikë edhe po thotë: "po bëjnë të tjerët...". Të gjithë kanë të drejtë, të barabartë janë të gjithë.

Unë si drejtues i seancës i kam shkruar me laps nja tri fjalë për këtë ligj edhe po jua lexoj qysh i kam të shkruara: Projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz e ka trajtën e një projekti, që nis nga ideja për t’u bërë vepër, që do të mbetet shenjë historike e kombit.

Pse ky formulim? Sepse, ligji në të vërtetë është i hartuar më shumë si një program kulturor historik, sesa si një ligj i kodifikuar. Ata që e kanë shkruar e dinë mirë që kështu është. Dhe, pjesët esenciale duhet të bëhen për t’u realizuar me elemente me akte nënligjore.

Shprehim përkrahje të plotë për këtë projekt, kurse ligji mund të plotësohet e të precizohet gjatë leximeve në Kuvend. Projektet, ose komplekset memorialë kanë rëndësi për identitetit historik e kulturor të kombit e të shtetit si pika mbështetjeje të ndërtimit e të nderimit popullor e nacional. Në këtë vështrim le të më lejohet ta trimëroj, ose inkurajoj komisionin e njëjtë, që e ka hartuar këtë ligj, që sa më parë ta sjellë në Kuvend një projektligj për memorialin “Ibrahim Rugova” në Prishtinë. Ky është mendimi im për këtë ligj dhe për problematikën.

Atëherë, meqë i kemi 63 deputetë këtu, po kthehemi në votimin e këtyre projektligjeve që i dëgjuam në lexim të parë. Ju lutem, bëhemi gati për votime.

Votojmë shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare.

Bëhemi gati për votim! Votojmë tani!

Kush është që nuk ka votuar, ose pa kartelë, ose që do të votojë? Edhe një, edhe një votë, që bëjnë 59 vota. Mungon një votë. A është dikush? A doni edhe një herë ta përsërisim?

Atëherë, ju lutem, bëhuni gati, regjia, deputetët. Votojmë tash!

Atëherë, një pa kartelë edhe 60, 61 votues. 61 deputetë kanë votuar, 56 janë për, asnjë kundër, 5 abstenojnë.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-158 për shoqëri tregtare.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në bazë të vendimit të seancës plenare të sotme, datë 30 mars 2017, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

(Ndërprerje e incizimit)

Edhe një herë, po thotë që në titullim u ka dalë tjetër ligj, por ne e votuam Ligjin për shoqëritë tregtare. Shkojmë tutje!

5. Votimi i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Diskutimi është kryer. I lus deputetët të përqendrohen dhe të votojnë!

Atëherë, bëhuni gati për votimin e Projektligjit për ndërmarrjet sociale në leximin e parë. Votojmë tash!

Kanë votuar 63 deputetë, 62 janë për, 1 është kundër, nuk abstenon asnjë.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndërmarrjet sociale.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në votimin, pas shqyrtimit të parë të Projektligjit nr. 05/l-138 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz

Diskutimet i kemi kryer. Ju lutem, bëhuni gati për votimin e këtij ligji. Votojmë tash!

Kanë votuar 65 deputetë, për kanë votuar 58 deputetë, 1 ka votuar kundër dhe 6 kanë abstenuar.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-138 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-142 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

E ftoj ministrin e Mjedisit, z. Ferat Shala. Nuk është. Atëherë,...

(Ndërprerje e incizimit)

Edhe një herë, se pyesin deputetët... Kjo seancë vazhdon nesër në orën 10:00, para se të nisë tjetra, sepse kemi kryesisht votime.

* * *

E premte, 31 mars

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 30 mars

Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të filluar më 30 mars 2017, me pikat e papërfunduara si vijon:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-142 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor, zotin Ferat Shala, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI FERAT SHALA: E nderuar kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të pranishëm,

Në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës kam nderin që para jush të paraqes Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Me këtë projektligj përcaktohen masat mbrojtëse për jetën dhe shëndetin e njerëzve, mjedisit dhe efekte të rëndësishme nga rrezatimi.

Masat për sigurinë bërthamore gjatë veprimeve lidhur për aktivitetin bërthamor, menaxhimin e mbetjeve radioaktive, mbikëqyrjen, zbatimin e masave, detyrimeve që kanë ndërmarrjet në praktikat menaxhuese si dhe përshtatjen dhe mbrojtjen nga sanksione të ndryshme.

Është e nevojshme të theksohet që ky projektligj nuk vlen për ekspozimin ndaj nivelit natyror të rrezatimit, të tillë si dhe radionukleideve që ndodhen në trupin e njeriut dhe rrezatimi kozmik që ndodhet në nivelin e tokës dhe natyrës.

Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguri bërthamore është pjesë e programit kombëtar të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe, për më tepër, është e rëndësishme të pretendohet se ky projektligj është në përputhje të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian që rregullojnë këtë fushë.

Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore është përgatitur nga Zyra e kryeministrit dhe gjatë hartimit të këtij projektligji janë konsultuar dhe realizuar dhjetëra takime me ekspertë vendës dhe ndërkombëtarë, përkatësisht me të gjithë aktorët e involvuar në këtë proces të hartimit të këtij draftligji.

Prandaj, është mirë dhe ndihem tepër mirë që sot para jush propozoj që ky draftligj të miratohet që do të ndihmojë në plotësimin edhe të kriteve të tjera që kemi në fushën e mjedisit dhe rrezatimit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,
Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Duda Bale, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit. Me që zonja Bale nuk është këtu, fjalën e ka Salih Salihu në emër të komisionit.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesuese!

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14. 3. 2017, shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë rekomandim që të miratohet në parim Ligji nr. 05/L-142 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore.

Me këtë rast po e paraqes edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Ne konsiderojmë se Kosovës i duhet një ligj i tillë, sepse deri më tash askush nuk është marrë me këtë çështje, asnjëherë nuk janë bërë matje në territorin e Kosovës për mbetjet radioaktive, përveç në vitin 2001 nga një kompani zvicerane.

Në anën tjetër, shkalla e vdekjeve nga kanceri në Kosovë është alarmante. Askush nuk e di prej nga po shkaktohet kanceri në Kosovë, a është nga rrezatimi radioaktiv, apo nga ushqimi i importuar? Këtë ne nuk e dimë, me këtë çështje ishte dashur të merret ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në përgjithësi mund të themi se ligji i ka disa të meta në aspektin gjuhësor, janë disa fjali të pakuptimta, megjithatë në leximin e dytë besoj që në komision do të merremi pak më tepër me këtë çështje.

Në këtë ligj nuk është paraparë themelimi i një laboratorit në kuadër të agjencisë që do të merret me matjen e mbetjeve radioaktive në ajër dhe në tokë në territorin e Republikës së Kosovës dhe aty thuhet se vetëm institucionet për matje duhet të jenë të akredituara, që mendohet në

institucionet private. Mirëpo, ne konsiderojmë se sikurse Agjencia i Ushqimit që e ka laboratorin e vet, që është agjenci shtetërore, duhet të ketë një agjenci shtetërore në kuadër të agjencisë, e jo ta lëmë gjithë këtë fushë në kuadër të institucioneve apo laboratorëve privatë, sepse është punë shumë e ndjeshme. Kemi të bëjmë me shëndetin publik të qytetarëve dhe është me interes që vetë agjencia të ketë përbrenda vetes një laborator, i cili kohë pas kohe do të bëjë matjet e ajrit dhe tokës në Kosovë në vendet ku pritet më shumë të ketë mbetjet radioaktive. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Radhën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Kush do të flasë në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së? Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit!

Zoti ministër,

Ky ligj në Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është diskutuar dhe është analizuar po ashtu dhe është një ligj i domosdoshëm për interes të vendit.

Ne në leximin e parë në parim japim mbështetje dhe do të japim kontributin në mënyrë aktive deri në leximin e dytë për ta plotësuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Ligjin për rrezatimin dhe sigurinë bërthamore dhe do ta përkrahë në parim. Kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve, në mënyrë që ky ligj të jetë më i mirë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, kush e do fjalën? Fjalën e ka zoti Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin dhe do ta japë kontributin në leximin e dytë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, fjalën e ka zoti Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Edhe ne si grup parlamentar kontributin tonë do ta japim në leximin e dytë. E përkrahim në parim këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: I ftoj shefat e grupeve parlamentare që t'i ftojnë deputetët të vijnë, sepse tani fillojmë me votime.

Po shkojmë në një pauzë 10 minuta, ndërkohë që nga shefat e grupeve parlamentare kërkoj... Nuk kemi kuorum, kemi votime. Të gjitha me radhë i kemi votime, kështu që ju lus që t'i ftoni deputetët të vijnë e fillojmë me votime.

Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Kërkoj falje, por megjithatë unë duhet të jap një mendim, në fund të fundit, jam deputet. Kam ardhur prej Prizrenit për të mbajtur seancë, ky koalicion i papërgjegjshëm është duke i maltretuar përpos neve, ashtu edhe qytetarët dhe nuk është korrekte të tregohet injorancë e skajshme, ta sulmojnë opozitën derisa vetë mungojnë.

Nëse nuk janë në gjendje të mbajnë seanca, po shkojmë në zgjedhje dhe vjen një legjislaturë tjetër më e përgjegjshme. Faleminderit!

KRYESUESJA: Atëherë shkojmë për 10 minuta pauzë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,
Ju lutem t'i zini vendet, sepse tash vazhdojmë me votim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

E përsëritim edhe një herë votimin. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

E kemi edhe një votë pa kartelë, domethënë gjithsej kanë votuar 69.
Për kanë votuar 69 dhe nuk kemi asnjë abstenim dhe asnjë votë kundër.

Faleminderit Arben për votën! Me një pa kartelë, gjithsej 70.

9. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në seancën e kaluar për këtë pikë nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, andaj në seancën e sotme riprocedojmë për votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë po e përsëris: E votojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Edhe pse në sallë janë të pranishëm 78 deputetë, po shihet që nuk janë votat e mjaftueshme, prandaj e shtyjmë për herën tjetër.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/ L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 10 mars 2017, por për mungesë të kuorumit për vendimmarrje për amendamentin e parë të propozuar nga deputeti Nait Hasani është ndërprerë procedimi i amendamenteve tjera. Andaj, sot vazhdojmë me riprocedimin e amendamentit të parë të propozuar nga deputeti Nait Hasani, si dhe të amendamenteve të tjera të propozuara sipas Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë amendamentet veç e veç.

Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Kryesuese!

Ligjin që e votuam ne ju duhet ta futni në procesverbal se ai ligj nuk e ka përfunduar procedurën e votimit, duhet të ripërsëritet kur të bëhen 61 votues atëherë e merr formën e prerë, përndryshe nuk mund të anulohet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Nuk thashë anulim, Shaip! Atëherë, përgatitemi për votim.

Amendamenti i 1. Lutet regjia të fillojmë me votimin. Votojmë tash!

Amendamenti i parë nuk kalon.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit të dytë. Votojmë tash!

Të gjitha amendamentet tjera janë me propozim të komisionit.

Të nderuar deputetë,

Meqenëse të gjitha amendamentet tjera janë propozim i komisionit, do të shkojmë me votimin në pako. Përgatituni për votim, regjia ju lutem. Votojmë tash!

E kemi edhe një votim pa kartelë, ju kisha lutur që edhe një herë ta përsëritim votimin, meqë në sallë janë 78 deputetë, po e përsëritim edhe një herë. Regjia, përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Po shkojmë për herë të tretë në votim. Regjia përgatitet për votim. Votojmë tash!

Regjia keni kujdes se cili amendament, në rregull jemi, atëherë vazhdojmë me votimin. Ju lutem, regjia le të përgatitet. Votojmë tash!

Në mungesë të kuorumit në vendimmarrje shtyhet votimi për seancën tjetër.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive

Të nderuar deputetë,

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandojmë miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Meqë deputeti Rexhep Selimi nuk është këtu, kush e merr fjalën në emër të komisionit? Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesuese!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj në parim dhe komisioni ka miratuar propozimin dhe amendamentet. Po ashtu këto amendamente janë miratuar edhe në komisionet e përhershme. Prandaj, i ftoj deputetët që ta përkrahin këtë projektligj dhe amendamentet. Ne e kemi një shqetësim, ndoshta është teknik, te neni 2, pika 1.2 e projektligjit, ku shkruan “ministri” nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme, do të thotë është një përmirësim ndoshta më shumë gjuhësor, nuk duhet të jetë “ministri”, por “ministra”.

Kështu që kisha kërkuar prej kolegëve të mi deputetë që ta votojnë këtë ligj sot. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit!

Tash fjalën e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Meqë askush nuk e dëshiron fjalën, atëherë në këtë projektligj nga Komisioni

Funksional janë propozuar 17 amendamente dhe vazhdojmë me votimin e këtyre amendamenteve në pako.

Regjia ju lutem, të përgatiteni. Votojmë tash!

A është edhe dikush tjetër pa kartelë?

Atëherë, gjithsej kanë votuar 76, për janë 75 dhe është një abstenim. Pra, konstatojmë se këto amendamente miratohen.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Regjia, ju lutem të përgatiteni! Votojmë tash!

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-134 për legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive.

Kanë votuar gjithsej 76, për janë 75 dhe kemi vetëm një abstenim.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandojnë miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetaren e Komisionit Funksional, zonjën Duda Balje, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

S obzirom na to da smo uočili neke male manjkavosti u okviru ovog zakona a u konsultaciji sa šefovima grupa i ministra, predlažem da nas podržite da ovaj zakon ide na treće čitanje. Hvala!

KRYESUESJA: Fjalën e kanë shefat e grupeve parlamentare. Ftoj shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së të marrë fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Kolegë deputetë,

Ministër,

Është adresuar pak me vonesë një shqetësim që vjen jo i adresuar, megjithatë, për herë të parë, që ka të bëjë me rregullimin e zhurmës përmes këtij projektligji.

Tash jemi në një situatë ku edhe nuk kemi shumë komoditet për t'u vonuar, se na duhet ky ligj. ka shqetësime të mëdha të qytetarëve, të adresuara drejtpërdrejt prej tyre, por edhe prej përfaqësuesve të tyre, kryetarëve të komunave, e tjerë... që duhet rregulluar kjo fushë njëherë e mirë me ligj.

Në anën tjetër, kemi të adresuara edhe shqetësime që kanë të bëjnë me institucionet fetare dhe mendoj, se ka një arsye shtesë që deputetët me ministrin bashkë me përfaqësues të komunave,

kryetarë komunash, nëse kanë interes në këtë kohë, po sidomos me përfaqësuesit e bashkësive fetare, të bëjnë edhe një herë nëse kanë mundësi që të rregullohet kjo fushë sa më mirë, në mënyrë që të trajtohet ky projektligj, të mbyllet njëherë e mirë.

Ka pasur kërkesa edhe më herët, që të mos trajtohen zhurmat ose tingujt që dalin nga institucionet fetare me këtë projektligj, ose të paktën mos të quhen kështu. Tash, ne jemi shumë vonë për të ndërruar diçka të tillë, por në lexim të tretë, si Parti Demokratike, kërkoj edhe nga grupet tjera parlamentare, që të jepet edhe një mundësi që të ketë edhe takime të shpejta me përfaqësues të bashkësive fetare, në mënyrë që ta zgjidhim, ta përmbylim këtë çështje njëherë e mirë.

Mendoj, se dokumenti i tashëm i projektligjit e jep një mundësi të mirë, që kjo të rregullohet sa më mirë që të jetë e mundshme, por edhe një konsultim shtesë me bashkësitë fetare të bëhet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-së.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar ministër,

Kabinet qeveritar,

Edhe ne po pajtohemi që të jepet edhe një mundësi, që ky projektligj të kthehet prapë në komision dhe komisioni bashkë me ministrin ta përpunojë dhe ato nene ku ka disa defekte dhe shqetësime nga grupet që janë këtu prezentë të përmirësohen.

Prandaj, pajtohem që të kthehet edhe një herë për lexim të tretë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, fjalën e ka Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Për shkak se sot se kam kartelën time, po flas me kartelën e zonjës Kadaj-Bujupi.

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah propozimin që ky projektligj të shkojë në lexim të tretë, ndonëse mendojmë se komisioni është dashur ta ketë një arsyetim lidhur me këtë, për shkak se sipas Rregullores duhet të ekzistojë një arsyetim, se për ç’arsye kërkohet leximi i tretë. Kjo nuk u bë nga kryetarja e komisionit, u mundua Zenuni pak a shumë ta bëjë të qartë këtë, mirëpo edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah që ky projektligj të shkojë në lexim të tretë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bali Muharremaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar ministër,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës mendon se ky ligj është me rëndësi për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe duke parë që ka mangësi edhe ne pajtohemi që ky ligj të shkojë në leximin e tretë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mufera Shinik në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit!

Teşekkür ederim,

Gürültüden korunma yasının ikinci okunuşuna Meclise gelmesi doğrultusunda Komisyonun yapmış olduğu çalışmalarında, teknik bazı hataların ortaya çıkmasından dolayı bugün özellikle ezan sesi

nin kısıtlanmaması doğrultusunda yaptığımız çalışmalardan dolayı üçüncü okunuşuna gitme şartını uygun gördük. Bunun için biz de yasa tasarısının özellikle ezan sesinin gürültü olmadığını belli etme doğrultusunda, bunun üçüncü okunuşuna gitmesini destekliyoruz.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

Në bazë të Rregullores nuk mund të procedohet kërkesa e kryetares së komisionit, zonjës Duda Balje, sepse kërkesa e saj është në kundërshtim me Rregulloren.

E vetmja mënyrë, siç e dini, në bazë të rregullores se si shkon në lexim të tretë është në rastin kur projektligji dhe amendamentet nuk i marrin votat e duhura. U pa një disponim i shumicës që kjo të shkohet në lexim të tretë, por këtë mund ta rregulloni vetëm përmes votimit.

Atëherë, procedojmë me votimin e amendamentit të parë. Regjia përgatitet për votim. Ju lutem, votojmë tash!

Ky amendament nuk kalon dhe shtyhet votimi për seancën e radhës.

(Ndërprerje e incizimit)

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Të nderuar deputetë,

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandojnë miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Muhamet Mustafa që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: E nderuara nënkryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç e thatë edhe ju, të gjitha komisionet funksionale edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë dhe Tregti kanë trajtuar këtë iniciativë ligjore dhe këtë ligj dhe në këtë ligj nuk ka pasur amendamente, t'ua përkujtoj se ky ligj vetëm se rregullon dhe autorizon shërbimin juridik të Agjencisë së Privatizimit, që të përfaqësojë interesat e Agjencisë së Privatizimit në ligjin e tashëm. Përfaqësimi në kontestet gjyqësore ka qenë i obligueshëm vetëm përmes avokatëve, ndërkohë që Agjencia e Privatizimit ka një shërbim shumë të kualifikuar juridik dhe në vend që të paguajë honorarë për avokatë, duhet ta kryejë këtë punë shërbimi i Agjencisë së Privatizimit dhe kursehen me qindra mijëra euro në kontekste. Prandaj, ju ftoj që ta votoni ligjin.

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani, nëse e dëshirojnë fjalën përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, si dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Atëherë, meqë askush nuk e ka kërkuar fjalën, procedojmë me votim. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash! A ka ndonjë pa kartelë? Atëherë, ju që jeni pa kartelë votoni për apo kundër? Albulenë, ju jeni për? Pra, gjithsej kanë votuar 69 deputetë, 2 prej tyre janë pa kartelë, për kanë votuar 55, kundër kanë votuar 9 dhe 4 kanë abstenuar.

Kuvendi miratoi Ligjin nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

14. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Të nderuar deputetë,

Nju njoftoj se Kuvendi në seancën e mbajtur më 9 shkurt 2017 ka votuar për këtë rezolutë, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Andaj, në seancën e sotme e riprocedojmë votimin e kësaj propozim-rezolute. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozim-rezolutës. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kuvendi nuk e miratoi rezolutën lidhur me arrestimet e aktivistëve të lëvizjes “Vetëvendosje” në mungesë të kuorumit. Pra, kjo nënkupton që do të vijë prapë në rend dite në seancën e radhës.

15. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Janë propozuar emrat e deputetëve, që do të jenë pjesë e komisionit, me përjashtim të Listës serbe dhe Lëvizjes “Vetëvendosje”. I lus këto dy grupe parlamentare që t’i japin propozimet për anëtarë të komisionit.

Fjalën e ka deputeti Sasha Milosavljeviq nga Lista serbe.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajuća!
Poslanička grupa Srpske liste predlaže za ad-hoc komisiju Jelenu Bontić.

KRYESUESJA: Faleminderit! Lëvizja „Vetëvendosje“ a ka ndonjë propozim?
Fjalën e ka shefi i grupit.

GLAUK KONJUFCA: Ne e dërgojmë Mytaher Haskukën.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se grupet parlamentare i kanë propozuar deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, si në vijim:

- Blerta Deliu-Kodra, kryesuese,
- Jelena Bontiq, zëvendëskryesuese e parë,
- Sadri Ferati, zëvendëskryesues i dytë,
- Xhevahire Izmaku, anëtare,
- Agim Kikaj, anëtar,
- Mytaher Haskuka, anëtar,
- Lahi Brahimaj, anëtar,
- Kujtim Paqaku, anëtar dhe
- Zafir Berisha, anëtar.

Atëherë, procedojmë me votim. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Rezultati është ky:

Kanë votuar gjithsej 70 deputetë, për janë 68 dhe 2 kanë abstenuar.

Prandaj Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që të veprojnë në përputhje me nenin 26, pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.

Fjalën e ka Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Jo, pata vetëm një propozim teknik, ashtu që të procedojmë më shpejt dhe unë propozoj që këto dy votime të ndodhin në të njëjtën kohë, pra të vendosen dy kuti dhe ta kryejmë votimin më shpejt, e të mos jenë dy procedura të ndryshme.

KRYESUESJA: Glauk, e kemi vetëm një votim.

16. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb

Komisioni Funkcional për Legjislacion i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga radhët e komunitetit serb dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e njërit prej kandidatëve të propozuar, si në vijim:

- Radojka Trifunoviq dhe
- Ivica Ivanoviq.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, zonjën Albulena Haxhiu, për ta arsyetuar raportin me rekomandim.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 5a të Ligjit nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor dhe në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2016 vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit për votimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit si vijon:

Pra, komisioni i ka propozuar 2 kandidatë:

- Radojka Trifunović dhe
- Ivica Ivanović.

Andaj i rekomandohet Kuvendit që të bëjë përzgjedhjen e njërit prej tyre.

Në ndërkohë, sa i përket qëndrimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, më duhet ta theksoj qëndrimin tonë.

Pra, ne si Grup Parlamentar nuk do ta përkrahim asnjërin prej këtyre kandidatëve. Janë dëshmitarë edhe anëtarët e komisionit që asnjëri prej tyre nuk e meriton të jetë anëtar i Këshillit Gjyqësor.

Merreni me mend, as çështjet elementare për përbërjen e KGJK-së, për përgjegjësitë e KGJK-së, nuk i kanë ditur.

Është fatkeqësi për Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të ketë kandidat, të cilët nuk i dinë as çështjet elementare me të cilat merret Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Unë i ftoj edhe deputetët e Kuvendit që të mos përkrahin propozime të tilla, por të shpallet konkursi, në mënyrë që në Këshillin Gjyqësor të Kosovës të jenë njerëz të cilët janë të profilizuar dhe njerëz profesionistë për këto çështje.

Njësoj ka qenë edhe rasti tek anëtari tjetër që e ka zgjedhur ky Kuvend. Pra, kemi pasur rastin e njëjtë dhe Këshilli Gjyqësor nuk ka nevojë për njerëz ose për degradime të mëtejme, për shkak se ne i dimë cilat janë problemet në Këshillin Gjyqësor, andaj është koha e fundit kur duhet t’u japim fund këtyre propozimeve, të cilat nuk e përmirësojnë kualitetin në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani radhët e kanë kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit për t’u deklaruar.

Deri më tani nuk është lajmëruar asnjëri, vazhdojmë tutje.

Mbështetur në nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 5a të Ligjit nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, zgjedhja e 1 anëtari në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës bëhet me votim të fshehtë, me shumicë të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Pra, në rundin e parë me 61 vota për.

Nëse në rrethin e parë kandidatët e propozuar nga komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, atëherë në rundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numër më të madh të votave.

Siç e patë, lista e propozuar përmban 2 kandidatë për 1 pozitë, kurse Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, zgjedh 1 anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës me mandat 5-vjeçar.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga 1 anëtar për Komisionin votues.

Atëherë, shkojmë me radhë. Kryetari i Grupit të PDK-së, zoti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: E propozoj deputetin Avdyl Ymeri.

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi i LDK-së, zoti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Ne e propozojmë Murat Hoxhën.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e propozon deputetin Mytaher Haskuka.

KRYESUESJA: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj, flet në emër të AAK-së.

DUAT HARADINAJ: Kryesuese, unë e kërkova fjalën më herët, por me gjasë edhe kapërceu. Janë shumë shqetësuese, për shembull, fjalët e Albulenës, që është kryetare e komisionit dhe tash po na thotë se s’kanë as kualifikim, e asgjë.

Pse, për shembull, të mos rishpallet konkursi. Për këtë arsye, Aleanca e bojkoton këtë komision.

KRYESUESJA: Zoti Haradinaj, kjo çështje së pari duhet të vijë në seancë, të refuzohet, e pastaj mund të rishpallet konkursi. Këtë gjë nuk mund ta bëjë kryetarja e komisionit e as komisioni. Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me zotin Zafir Berisha, në emër të “Nismës”.

ZAFIR BERISHA: Jo, Haxhi Shala është anëtar i komisionit.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, zonja Mufera Shinik e ka fjalën.

MUFERA SHINIK: Grupi Parlamentar “6+” e propozon deputetin Qerim Bajrami.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Listës serbe fjalën e ka Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajuća!

Na početku moram da kažem da je vrlo uznemiravajući to što od predsednice dolazi poziv da se ne glasa ni za jednog kandidata koji je predložen od strane Komisije, jer ako su oni predloženi od strane Komisije, znači da ispunjavaju neke osnovne elementarne uslove i da pozivam sve kolege poslanike da glasaju za člana Sudskog saveta i da Sudski savet bude formiran, a za članove Komisije predlažem Sašu Milosavljević.

KRYESUESJA: Faleminderit! Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për formimin e këtij komisioni.

Kush është për?

A ka kundër? 2.

Atëherë konstatoj se Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e 1 anëtari për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Lus komisionin që të fillojë me procedim, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës.

* * *

KRYESUESJA: Fillojmë me votimin, shkojmë pra sipas radhës alfabetike:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti.

Lus komisionin që të mos jap fletëvotime pa radhën që i thërrasim deputetë. Atëherë vazhdojmë me thirrjen e emrave, pavarësisht mënyrës se si keni votuar ju.

Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Qaushi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Fatmir Shurdhaj, Faton Topalli. Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kimete Bytyqi, Kujtim Paqaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkollli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nehat Baftiu, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emmini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Fjalën e ka kryetari i komisionit.

ABDYL YMERI: Fillojmë me numërimin, kanë marrë pjesë 69 deputetë në votim.

Radojka Trifunović
Radojka Trifunović
E pavlefshme
Radojka Trifunović
Ivica Ivanović
Radojka Trifunović
E pavlefshme
Radojka Trifunović

Radojka Trifunoviq
Ivica Ivanoviq
Ivica Ivanoviq
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
E pavlefshme
E pavlefshme
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Ivica Ivanoviq
Radojka Trifunoviq
E pavlefshme
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Ivica Ivanoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
E pavlefshme
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
E pavlefshme
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq

Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Ivica Ivanoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Ivica Ivanoviq
E pavlefshme
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Ivica Ivanoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq
Radojka Trifunoviq.

Komisioni votues për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komunitetit serb paraqet këtë:

R a p o r t

Për rezultatet e votimit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komunitetit serbë mbështet te neni 108.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 5a të Ligjit nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223, për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit, më 31 mars 2017, në përbërje: Abdyl Ymeri, Murat Hoxha, Mytaher Haskuka, Sasha Milosavleviq, Haxhi Shala, Qerim Bajrami. Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehur dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor nga radhët e komunitetit serbë, në seancë plenare të mbajtur, më 31 mars 2017, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 69 deputetë.
Të pavlefshme janë 15 fletëvotime,

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim: Radojka Trifunović ka fituar 46 vota dhe Ivica Ivanović ka fituar 8 vota.

Me këtë konstatojmë se do të hyjmë në radhën e dytë të votimit edhe një herë, sepse s'ka kaluar asnjë kandidat, i cili do t'i marrë 61 vota.

KRYESUESJA: Faleminderit! Atëherë, meqë shkohet në rundin e dytë të votimit tani shkojmë në pauzë deri në orën 14:00 dhe kthehemi për të votuar për rundin e dytë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

Nuk kemi kushte për ta vazhduar mbledhjen, në mungesë të kuorumit. Për vazhdimin e saj do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

* * *

E martë, 11 prill 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 30 dhe 31 mars

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në seancat e kaluara për votim kanë mbetur disa pika të rendit të ditës, për të cilat kanë mbaruar diskutimet dhe kanë mbetur vetëm votimet. Këto kanë të bëjnë me vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të filluar më 30 dhe 31 mars 2017. Prandaj, fillojmë me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim:

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë.

9. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet

Ju njoftoj se në seancat e kaluara për votimin e kësaj pike nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, andaj në seancën e sotme e riprocedojmë votimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet. U lutem regjisë dhe deputetëve që të bëhen gati për votim, votojmë tash!

Në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, pika shtyhet, pra kanë votuar vetëm 50, e duhet të votojnë 61 deputetë.

14. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kërkohej deklarimi me votim për miratimin e Projekt-rezolutës, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, kanë votuar vetëm 29. Shtyhet pika e rendit të ditës, s'ka kuorum votimi.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 10 mars 2017. Në seancën plenare të mbajtur më 31 mars 2017 është proceduar për votim amendamenti nr. 1 i këtij projektligji, i cili nuk është miratuar. Kryesuesja e seancës i hodhi në votim amendamentet nga 2 deri në 15, por nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Andaj, sot procedojmë amendamentet prej 2 deri në 15, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL. I votojmë amendamentet veç e veç.

Amendamenti nr. 2. Votojmë tash!

Atëherë, ju thërras edhe një herë për amendamentin nr. 2. Votojmë tash!

Kanë votuar 38 deputetë, që është kuorum i pamjaftueshëm për të votuar amendamentet dhe ligjin në tërësi. Shtyhet!

16. Votimi për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komunitetit serb (rundi i dytë)

Në seancën plenare të mbajtur më 31 mars 2017 është mbajtur rundi i parë i votimit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb, por asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Andaj, sot procedojmë me rundin e dytë të votimit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb. Komisioni votues, i formuar në seancën plenare më 31 mars 2017, si dhe Administrata të fillojnë me procedimin e votimit, ndërsa deputetët ftohen të votojnë sipas listës.

Komisioni është: Abdyl Ymeri i PDK-së, Murat Hoxha i LDK-së, Mytahir Haskuka i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Sasha Milosavljeviq, LS, Haxhi Shala i “Nismës” dhe Qerim Bajrami i Grupit “6+”.

Këta duhet të dalin, janë anëtarë të komisionit, Haskuka s'qenka, a doni ta ndryshoni? “Vetëvendosje”? Urdhëro, Albulenë!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Deputeti Haskuka nuk është këtu, mirëpo meqë qëndrimi ynë është të mos përkrahen kandidatët në fjalë, të cilët domethënë i ka rekomanduar Komisioni për Legjislacion, ne nuk e dërgojmë asnjë deputet në këtë komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Ai është problem tjetër, unë thashë në komision a e emëroni atë njeri? Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, një anëtar të komisionit, ju lutem! Urdhëro, Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Grupi Parlamentar, nuk dërgon anëtar në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma”, Haxhi Shala, a është këtu? A doni ta caktoni dikë tjetër? Nuk doni! Kush? Valdete Bajrami, a e ndërroni Haxhi Shalën a jo?

VALDETE BAJRAMI: Edhe “Nisma”, ashtu si partitë e tjera opozitare, e tërheq Haxhi Shalën, nuk merr pjesë fare.

KRYESUESI: Atëherë, i lus Abdyl Ymerin, Murat Hoxhën, Sasha Milosavljeviq edhe Qerim Bajrami që ta kryejnë detyrën, se janë anëtarë komisioni.

Abdyl Ymeri, Murat Hoxha, Sasha Milosavljeviq edhe Qerim Bajrami.

Komisioni, a jeni të gatshëm për t'ia filluar votimit? Atëherë, fillojmë:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Balu Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Çausi, Duda Balje Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Shurdhaj, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kimete Bytyqi, Kujtim Paqaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkollli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytaher Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nehat Baftiu, Nenad Rashedi, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Çela, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Sali Salihu, Salije Mustafa, Sasha Milosavljeviq, Selvije Halimi, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

(Ndërprerje e incizimit)

Veton Berisha, a ke votuar ti?

(Ndërprerje e incizimit)

Komisioni, urdhëroni!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Poštovane kolege,

U drugom krugu glasanja za jednog člana Sudskog saveta ispred srpske zajednice glasalo je 65 poslanika, i to na sledeći način:

Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Ivica Ivanović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
E pavlefshme,
Radojka Trifunović,
Nevažeći,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Ivica Ivanović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Nevažeći,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Nevažeći,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Ivica Ivanović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Ivica Ivanović,
Nevažeći,

Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Ivica Ivanović,
Nevažeći,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Ivica Ivanović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Nejasno, nevažeći,
Nevažeći,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović,
Radojka Trifunović.

KRYESUESI: Urdhëroni, Komisioni e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Në votim kanë marrë pjesë 65 deputetë, të pavlefshme janë 8.

- Radojka Trifunović, 51 vota,
- Ivica Ivanović, 6 vota.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në bazë të raportit të Komisionit votues, Kuvendi e zgjodhi Radojka Trifunovićin anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga radha e komunitetit serb me mandat pesëvjeçar.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance.

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë